



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 DHE 30 TETOR 2024**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 16. I 30. OKTOBRA 2024. GODINE**

TETOR - OKTOBAR
2024

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për procesin e përlogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe për mënyrën dhe për bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o procesu obračuna dugovanja ambalažiranja vode, kao i o načinu i o osnovici otplate duga od strane Ministarstva životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Enver Hoxhaj.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Më lejoni t'i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me kërkesën e 41 deputetëve të Kuvendit. I ftoj të gjithë deputetët që të ulen, meqë e kemi edhe një ngjarje paraprake.

Të nderuar deputetë, para se të kalojmë në rendin e ditës, ju ftoj që të mbajmë një minutë heshtje për të shprehur dhimbjen tonë për ndarjen nga jeta të komandantit të parë të KFOR-it në Kosovë, gjeneralit Sir. Mike Jackson.

Ju lutem për një minutë heshtje!

Qoftë i përjetshëm kujtimi për gjeneralin Mike Jackson!

Tash, vazhdojmë me punimet e kësaj seance.

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 69, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 68, paragrafit të tretë të Rregullores së Kuvendit. 41 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë kërkuar seancë të jashtëzakonshme për të debatuar në lidhje me procesin e përllogaritjes së borxheve të kompanive të ambalazhimit të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, si dhe kanë propozuar rezolutë për miratim.

1. Debat parlamentar për procesin e përllogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe mënyrën dhe bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Ftoj deputetin Ferat Shala, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që në emër të deputetëve nënshkrues ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar kjo seancë e jashtëzakonshme që po mbajmë sot.

FERAT SHALA: Faleminderit! Përshëndetje, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Të nderuar qytetarë,

Po e fillojmë këtë seancë të jashtëzakonshme për disa arsye. Arsyeja e parë është sepse më 23 prill 2024 zyrtarisht kemi kërkuar dhe parashtruar kërkesë për themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për këtë çështje nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike. Duke mos gjetur

mbështetjen në këtë iniciativë dhe duke u orvatur dhe shmangur kësaj procedure legale dhe legislative, mazhoranca na sjell deri në këtë moment. Po ashtu, më 27 shtator 2024, përsëri grupi parlamentar ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar po për të njëjtën çështje.

Përsëri kemi ikje nga përgjegjësia dhe sabotim të këtyre punëve të Kuvendit. Në pamundësi për të realizuar këto dy kërkesa, sot jemi këtu bashkërisht si opozitë në seancë të jashtëzakonshme për të njëjtën temë, çështjen e aferave tashmë publikisht të njohur korruptive të ambalazhuesve të ujit.

Tashmë, drejtësia dhe institucionet e tjera shtetërore kanë ndërmarrë hapa konkretë për hetimin dhe zbardhjen e kësaj afere korruptive me përmasa dhjetëra milionë euro. Dëmi financiar për buxhetin e shtetit është mbi 10 milionë euro të ditura deri më tani nga media dhe opinioni i gjerë. Dëmi i madh i imazhit kompanive dhe ambalazhuesve është shkaktuar me ose pa vetëdijen e tyre nga institucionet e shtetit. Ne nuk kemi për qëllim e as synim të dëmtojmë prodhimin vendor, por nuk pajtohemi me prodhuesit që janë pjesë e skemave korruptive, e të cilët me ose pa dashjen e tyre kanë rënë pre e mashtrimeve korruptive edhe atëherë kur vetë institucionet e shtetit u kanë kërkuar diçka të tillë si në rastin konkret.

Pra, tema është çështja e ambalazhuesve, kohëve të fundit mediat e shkruara dhe opinioni publik është formuar dhe shkruar dhe na kanë informuar mediat për shumë afere në këtë sektor, veçanërisht në sektorin e ujit. Me theks të veçantë çështja e kalkulimit dhe shlyerjes së borxheve të ambalazhuesve të ujit.

Në këtë fazë të diskutimit publik kanë qarkulluar vendime të shumta të mjeteve financiare, të cilat pretendohet se ministria dhe organet e tjera të institucioneve të sektorit të ujit kanë kryer veprimtari apo dëm buxhetit të shtetit. Në pamundësi që të kemi një pasqyrë reale, një raport kredibil të besueshëm për të gjitha këto që kanë ndodhur në këtë sektor, ne po kërkojmë informacion shtesë, bashkërisht, për mënyrën e menaxhimit të sektorit të ujit, për respektimin e ligjit, për mbarëvajtjen financiare të sektorit.

Për të gjitha këto ne duhet të kemi informacion të plotë dhe transparent, parimisht qytetarët dhe opinioni i gjerë publik, as deputetët e këtij Kuvendi dhe këtij Parlamenti nuk besoj që e kanë të qartë tërësisht problemin e krijuar nga qeveria. Nuk e kanë të qartë as mënyrën e menaxhimit, as respektimin e aq më pak nuk i kemi të qarta shumatat financiare të llogaritet që është dëmtuar buxheti i Kosovës.

Ne si deputetë, por edhe Qeveria si mekanizëm ekzekutiv e ka obligim ligjor të jetë e hapur me publikun dhe të jetë transparent në punën e saj, gjë të cilën nuk e kemi parë deri më tani dhe nuk jemi duke e parë dhe sot. Sot mungon ministri, Kabineti qeveritar, kryeministri dhe hesht, edhe pse këtu nuk është, hesht dhe ik nga përgjegjësia dhe llogaridhënia.

Andaj, arsyeja e vetme e kërkesës tonë për këtë debat të jashtëzakonshëm është transparenca dhe e vërteta. Pra, para se të fillojmë diskutimet, kërkojmë nga Qeveria, gjegjësisht ministria që kërkesat tona t'i marrë të mirëqena si kërkesa demokratike dhe ligjore.

Por, ne kërkojmë përgjegjësi dhe llogari edhe për pyetjet si në vijim, pra kemi dilemat tona: A është respektuar Ligji për temën që po trajtojmë? Tash, hapat e veprimeve që ka ndërmarrë shteti po tregojnë që nuk është respektuar. A është menaxhuar sektori i ujit mbi bazën e legjislacionit në fuqi? Kush dhe si menaxhon me sektorin e ujërave në Kosovë? Pse edhe pas tre vjetësh qeverisje institucioni i ujërave në Kosovë udhëhiqet nga ushtrues detyre krejtësisht në mënyrë të paligjshme.

Ne duhet të dimë sa është numri i operatorëve të ujit, gjegjësisht ambalazhuesve? Ne duhet të dimë saktë sa janë borxhet e këtyre operatorëve? Ne duhet të dimë sa këto borxhe janë inkasuar në buxhetin e shtetit dhe si janë inkasuar? Ne duhet të dimë sa borxhe kanë mbetur pa u inkasuar në buxhetin e shtetit? Opinioni duhet ta dijë çfarë aktesh dhe vendimesh juridike ka nxjerrë kjo qeveri në raport me operatorët e sektorit të ujërave? Mënyra e kalkulimit dhe shumat financiare, të cilat operatorët i kanë realizuar. Mënyrën e negocimit dhe ndryshimit të shumave nga miliona euro, në dhjetëra mijëra euro. Ne duhet të dimë shlyerjen e borxheve nga kompanitë e caktuara. Si u përjashtuan disa nga kompanitë në pjesën e vendimmarrjes të menaxhimit dhe pse nuk iu është dhënë rasti disa kompanive të caktuara fare që të jenë pjesë e procesit të shlyerjes së borxheve?

Pra, sa kompani ose operatorë ekonomikë kanë mbetur jashtë trajtimi të procesit të shlyerjes së borxheve? A është krijuar pabarazi në mes të operatorëve ekonomikë të të njëjtës veprimtari prodhuese dhe pse? Ne duhet të kemi qartë se si do të veprojmë në të ardhmen që operatorët ekonomikë që nuk janë trajtuar nga procesi i faljes së borxheve, pra kemi një kategori që fare s'i kemi trajtuar. Sa është dëmtuar buxheti i shtetit dhe nga kush është dëmtuar, dhe pyetja shumë e rëndësishme që ka mbetur e pasqaruar deri më sot është: çka po ndodh me lejet mjedisore për operatorët, gjegjësisht ambalazhuesit?

Kjo pjesë e shqetësimeve tona që ngritëm ka një kronologji ngjarjesh, memoria institucionale e thotë qartë se kur Qeveria Kurti ka ardhur në pushtet ka trashëguar në sektorin e ujërave një borxh prej rreth 52 milionë e më shumë euro. Ky borxh i mbetur ndër vite është temë dhe fokusi kryesor korruptiv, të cilin kjo qeveri dhe kjo ministri e ka trajtuar tash e 4 vjet. Borxhi i ambalazhuesve ka qenë i regjistruar dhe i përgatitur sipas legjislacionit në fuqi, e legjislacioni e thotë qartë që ky borxh nuk mund të falet e as të shlyhet.

Pra, Qeveria me instancat e larta të saj, e zbulon një metodë dhe praktikë tjetër, metodën e re negocimit, metodën e re të kalkulimit dhe metodën e selektimit të ambalazhuesve dhe të borxheve. Për të realizuar këtë projekt të paligjshëm e korruptiv, duhet nxjerrë akte normative

dhe duhej krijuar grupe, nëngrupe punuese për të manovruar dhe kalkuluar për interesa të grupit të ngushtë të inkriminuar që tashmë edhe drejtësia i njeh.

Në fillim, grupi i interesit pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka ndarë ambalazhuesit në dy kategori: të përshtatshëm për komunikim dhe pazare dhe grupi i dytë i ambalazhuesve që ishin lënë me një anë dhe nuk trajtoheshin me problemet që kishin realisht dhe juridikisht. Ministria përmes kuadrove të dëgjura dhe të emëruara si ushtrues detyre filloi të realizoi projektin më korruptiv të mundshëm me pasoja të mëdha për buxhetin e shtetit. Deri te ky konstatim dhe këto dilema kemi ardhur duke u mbështetur në disa akte juridike dhe vendime zyrtare të Ministrisë së Mjedisit dhe Infrastrukturës, të cilat parimisht janë veprime tashmë dhe publike.

Pra, kemi Vendimin nr. 4203/21 të datës 4. 10. 2021, i lëshuar nga MMPHI. Kemi Vendimin nr. 5101 të datës 11. 11. 2021 i lëshuar po nga ky institucion. Kemi raportin mbi gjendjen e ambalazhuesve të ujit, raport zyrtar i ministrisë. Kemi aneksin, plotësimin e raportit përfundimtar të grupit punues ndërministror për llogaritjen e detyrimeve financiare nga operatorët që nuk kanë raportuar.

Kemi njoftimin dhe vendimin preliminar për detyrim financiare që u është dërguar operatorëve. Kemi raportin e auditorit të brendshëm të datës 8. 2. 2021 dhe shumë akte dhe nën akte tjera legislative të nxjerra nga këto organe të Ministrisë së Mjedisit dhe Infrastrukturës. Gjatë këtij procesi dhe këtyre akteve janë krijuar disa grupe në kuadër të ministrisë, me theks të veçantë në Autoritetin e pellgjeve lumore, ku janë nxjerrë raporte e kalkulime financiare, e të cilat dyshojmë që nuk kanë përfillur bazën ligjore. Dhe i është shkaktuar dëm buxhetit të vendit.

Krejt ky proces në bazë të lartë dyshimi nuk ka shkuar në heshtje, pa qenë të informuar zyrtarët më të lartë të shtetit, pa qenë i informuar kryeministri dhe ministri. Tashmë është publike falë edhe mediave që edhe kryeministri, edhe ministri kanë qenë të informuar për të gjitha këto afera me e-mail zyrtarë nga sinjalizuesit brenda Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Pra, si ka mundësi që më shumë se tre vjet kryeministrit gjithë levat e tij shtetërore kanë informacion të shkruar dhe nuk veprojnë. Që është e vërteta veprojnë duke ndjekur, persekutuar dhe larguar nga puna pikërisht sinjalizuesin, i cili i paralajmëronte për shkeljet permanente antiligjore dhe dëmin që po i bëhet buxhetit të shtetit. Pra, i vetmi reagim shtetëror që kemi parë tash e tre vjet në këtë relacion është...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia zgjatni fjalën deputetit sa të ketë nevojë.

FERAT SHALA: Faleminderit, kryesues!

Pra, ne nuk kemi parë asnjë veprim juridik, nuk kemi parë asnjë veprim administrativ përveç ndjekjes dhe persekutimit juridik dhe njerëzor, ku shkarkohet, largohet nga puna e kështu me radhë sinjalizuesi.

Falë mediave, sot ne kemi shumë informacione shtesë dhe konsideroj dhe besoj që drejtësia dhe të gjithë ne bashkërisht do të ndihmojmë që ky proces të zbardhet dhe të marrë epilog merititor.

Faleminderit të gjithëve!

KRYESUESI: Pas fjalës së propozuesit në emër të deputetëve nënshkrues, tash e ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zotin Tahiri, që ta marrë fjalën.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të flas për kapelat, po e ngre një çështje tjetër, pra në këto momente për kureshtje vendosa me e pa se a është duke transmetua Radiotelevizioni i Kosovës këtë seancë live dhe e pashë që Radiotelevizioni i Kosovës në këtë moment në programin qendror paska vendosur ta transmetojë një konferencë të Kryeministrit Kurti për të mbijetuarit e dhunës seksuale.

Ndërsa, Kuvendin e Kosovës, institucionin të cilin e ka themeluar ky institucion, paska vendosur ta transmetojë në RTK3. Pra, kjo s'ka ndodhur kurrë, asnjëherë. Këto kapelat e Lëvizjes Vetëvendosjes, Dejonës, që janë Radiotelevizioni i Kosovës, janë duke e bërë këtë krim, ky është krim dhe kjo është një tendencë për ta mbytur zërin opozitar, kjo është një tendencë t'i mbytë ata, të cilët i denoncojnë krimet, ata të cilët arrijnë të shpërfaqin hipokrizinë dhe kriminalitetin e këtij Kuvendi. Radiotelevizioni i Kosovës është institucion i themeluar nga ky Kuvend dhe nuk ka ndodhur asnjëherë që në RTK1, në të njëjtën kohë apo në programin qendror, të ketë diçka tjetër kur ka seancë në Kuvendin e Kosovës.

Pra, të nderuar qytetarë, të dashur deputetë të opozitës, duhet pasur të qartë me çka po ballafaqohemi, me çka jemi duke u ballafaquar dhe me çka do të ballafaqohemi. Pra, angazhimi të mbytet zëri opozitar, të mbytet kritika në secilindo variant, sot jemi në 3, nëse i lëmë kështu, edhe pak as në 3 s'kemi për të qenë. Kështu janë duke vazhduar këta, kjo është gjendja në Kosovë, të mbytet secili zë, të kërcënohet secili që arrin të nxjerrë një të vërtetë, një abuzim të këtij pushteti.

Të flasë në këtë Kuvend, t'u flasësh këtyre kapelave, është sikur t'u flasësh deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, për besë, është e njëjta. Këta kanë vendosur të jenë kapela, këta kanë vendosur të jenë masha e Dejonës, të jenë instrumente, këta s'i pyet kurrkush. Këtyre u kallëzojnë kur duhet të vijnë në seancë, u kallëzojnë kur duhet votuar, u kallëzojnë kur duhet

bërtitur, pra këta s' dinë, këta janë të shkretë. U bien në qafë, kapelave të Dejonës veç u biem në qafë.

Të nderuar kolegë deputetë, pra përmes këtyre kapelave të zeza që na e nxori në pah Dejona, shefja e tyre, këta kanë vendosur t'i mbulojnë shumë krime, mund t'i mbulojnë përkohësisht, mirëpo jo përjetësisht. Këta kanë vendosur që nëpërmjet këtyre kapelave ta mbulojnë krimin me faljen e borxheve të ujit që shkon rreth njëzet milionë euro, njëmbëdhjetë të dokumentuara dhe nëntë të tjera të cilat janë në dokumentim e sipër.

Këta kanë vendosur që përmes këtyre kapelave ta mbulojnë krimin edhe me bukën e Ushtrisë së Kosovës. Këta kanë vendosur që përmes kapelave ta mbulojnë krimin edhe në rezervat shtetërore, edhe në vaj e miell, ku na kanë vjedhur edhe në rezervat shtetërore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Në fundin e këtij mandati, në rrethana normale, do të duhej të vinin dhe të na tregonin këta cilat janë punët e tyre. Çka kanë bërë për tri vite e gjysmë? Po, nuk kanë çka të prezantojnë, nuk kanë çka t'u flasin qytetarëve të Kosovës. Më së lehti është ta vësh këtë kapelën e zezë në kokë edhe të fshihesh. Po pak ditë mund të fshihen. Shumë pak. Sepse, 9 shkurti do t'ua heqë kapelën prej kokës. 9 shkurti do ta nxjerrë një situatë të re në vendin tonë. Kjo situatë është e patolerueshme. Tendenca e tyre, angazhimi i tyre për ta mbytur secilin zë opozitar, secilin zë kritik, ta mbytin secilin person që e nxjerr një abuzim të tyre, nuk do ta tolerojmë.

Akoma më e rëndë se krejt këto, është sjellja e Radiotelevizionit të Kosovës në raport me këtë seancë dhe në raport me këto kritika.

Të nderuar kolegë deputetë,

Gjatë kësaj periudhe edhe sa na kanë mbetur, do të ballafaqohemi edhe me shumë situata të tilla. Edhe me shumë angazhime të tyre, të cilët në secilin variant do të mundohen ta ndalin angazhimin e opozitës, edhe angazhimin e gazetarëve e shoqërisë civile.

Por, mendoj që është shumë e rëndësishme që të mos dorëzohemi, të kemi një angazhim të përbashkët dhe ta nxjerrim krejt këtë kriminalitet dhe krejt këto krime që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Këta s'kanë fytyrë të vijnë, s'kanë argumente që të ballafaqohen. Mesazhet e Dejona Mihalit e nxjerrin në pah më së miri kriminalitetin në vendin tonë.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po jua jap veç një shembull. Një hulumtim të shkurtër, ku Dejona Mihali i thotë: fol me Ergysin, se nuk bën të ketë reduktime assesi këto dy ditë. Edhe, isha shumë kureshtar ta shoh kush është

Ergysi. Kush është Ergysi që neve na e bën të mundur të na furnizojë me energji elektrike, të mos ndalet rryma në Kosovë. Edhe Ergysi doli të jetë ish-drejtori i Korporatës Energjetike Shqiptare në Shqipëri. Pra, imagjinojeni, një person jozyrtar i cili e ka në dorë sistemin tonë energjetik, vendos edhe kur ta blejmë rrymën, e kur ta shesim rrymën. Pra, edhe shitblerjen e energjisë elektrike. Mos të flasim punësimet, mos të flasim tenderët njëburimorë që janë rreth 105 milionë euro për dy vjet që i ka bërë KEK-u. Pra, edhe shitblerjen e energjisë elektrike vendos Dejana Mihali kur të ndodhë në Kosovë. Thotë: fol me Ergysin, me drejtorin e Korporatës Energjetike Shqiptare në Shqipëri.

Pra, në dorë të kujt e kemi sistemin tonë energjetik. Kush vendos në këtë vendin tonë kur të blihet rryma, kur të ndalet rryma. Kush vendos në vendin tonë kur të lëshohet rryma, kur të ndalet rryma.

Për besë, është situatë e mjerueshme. Ne ndonjëherë kam përshtypjen kur po ballafaqohemi me fakte të tilla, nuk po e dimë saktë se ku po jetojmë. Nuk po e dimë saktë se kush po na udhëheqë dhe nuk po e dimë saktë se cilat janë këto ndërmarrjet në prapaskenë që ne nuk jemi duke i parë.

Pas një hulumtimi, del një zyrtar i tyre, siç ishte ai Naser Hafizi, që këta Naser Hafizë janë të gjithë, del që për një vit i ka qarkulluar rreth katërqind mijë euro, para këto të deponuara në bankë, për një periudhë të shkurtër para të deponuara. Imagjinoje, sa Naser Hafiz janë të cilët ne nuk i dimë, të cilët i kanë mbuluar me kontrata njëburimore, të cilët i kanë mbuluar me kontrata sekrete. Sa e sa të tillë do të dalin në të ardhmen, që do të ballafaqohemi me ta.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kriminaliteti, fatkeqësisht duket të jetë përtej asaj që po e shohim. Edhe angazhimi i tyre për ta mbuluar këtë kriminalitet, duke u mundur të na e ndalin zërin në secilin cep, është jashtëzakonisht i madh, është në dorën tonë të vendosim a duhet t'i tolerojmë ta mbysin zërin pak e nga pak apo po duam të ngrihemi e të kemi një angazhim opozitar së bashku me mediat, së bashku me shoqërinë civile, me të gjithë, për ta ndaluar kriminalitetin, për ta ndaluar kriminalitetin në vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash, shkojmë sipas radhës së grupeve të tjera parlamentare. E ftoj z. Armend Zemaj, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit

Të nderuar kolegë të pranishëm,

Të nderuar media,

Besoj që do ta përcillni mesazhin dhe shqetësimet tona të thirrur në këtë seancë të jashtëzakonshme që edhe për ne, po sigurisht edhe për kolegët këtu deputetë të Vetëvendosjes,

sot do të duhej të ishin të mbushura, edhe ata të dëgjonin qëndrimet e tyre lidhur me korrupsionin e madh që po e bën partia e tyre, Lëvizja Vetëvendosje me Qeveri.

Fatkeqësisht, ky pushtet i dështuar po i ikën edhe përgjegjësisë që duhet të jetë para qytetarit që e votoi me premtimin e madh se do të bëjmë Qeveri me duar te pastra dhe do ta luftojnë korrupsionin. Tani, vetë faktet e thonë se kjo Qeveri veç duart e pastra nuk i ka, i ka zhytur thellë në korrupsion, madje në korrupsion të shkallës së lartë.

Aferat korruptive të tyre po e gjejnë dritën e publikimit çdo ditë, sepse nuk fshihen gjatë. Ngjashëm e kemi rastin edhe me temat për të cilën e kemi thirrur këtë seancë, dëmtimin e buxhetit të shtetit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me një kryepersonazh Naser Hafizi me miliona euro për shlyerjen e borxheve në forma të kundërligjshme për kompanitë kosovare të ambalazhuesve të ujit. Si edhe publikimin e mesazheve ku Dejana Mihali në komunikim me tashmë të arrestuarin Nagip Krasniqin, diskutojnë po ashtu për korrupsionin në Korporatën Energjetike të Kosovës.

Kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Ta rikujtojmë se Hafizi është ndonjë person i parëndësishëm. Ai është njeri i afërt, ose shumë i afërt me Kurtin. Ndërsa, Dejana është vetë Kurti. Të dy rastet tregojnë se kjo Qeveri është zhytur në korrupsion. Këta njerëz janë shkurt e shqip, struktura kriminale.

Pyetjet që kërkojnë përgjigje për ne dhe qytetarët e Kosovës, duhet ta dimë si ka mundësi njeriu i quajtur Naser Hafizi, me pagën pak më shumë se shtatëqind euro, të blejë katër banesa, prona dhe veç në muajin shkurt të këtij viti që këtë qarkullim bankar mbi katërqind mijë euro. Pse nuk janë alarmuar institucionet përgjegjëse me kohë për disproporcionin e madh në krahasim me të hyrat e tij? A deri këtu e ka kapur shtetin kjo Qeveri, e cila edhe sot del dhe i mbron njerëzit e korruptuar?

Tjetra, a mund ta dimë pse një person i quajtur Dejana Mihali, pa asnjë pozitë në Qeveri, vendos kur duhet të ndalet rryma, çfarë të komunikohet dhe si të komunikohet për punë, për punësime dhe për zhvillim. Kësaj s'mund t'i themi gjë tjetër, veçse organizim i një skeme kriminale, pa frikën e përgjegjësisë dhe pa brengën e llogaridhënies.

Kjo skemë e krimit financiar mirë organizua, fatkeqësisht e strukturuar në Qeveri, e kontrolluar nga parapolitika e krimit duhet doemos të zbardhet nga organet e drejtësisë. Këta njerëz premtuan parajsë dhe përfunduan, duke i varfëruar qytetarët e pasuruar xhepin e tyre.

Prandaj, Lidhja Demokratike e Kosovës do të shfrytëzojë të gjitha mekanizmat institucionalë, ligjorë dhe kushtetues për të zbardhur deri në fund të gjitha rastet e krimit, korrupsionit dhe keqpërdorimeve në këtë Qeveri. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, kryetari i grupit, z. Tahiri.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit kryesues, nënkryetar, profesor Hoxhaj!

Të nderuar deputetë prezent,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi mbledhur në Kuvend si deputetë nënshkruar të kërkesës për një debat të jashtëzakonshëm, në një seancë të jashtëzakonshme, me të vetmin qëllim që ta zbardhim një skandal a super-skandal, i cili është i shumti në këto vite e që është me interes të publikut dhe qytetarëve dhe zbatimit të ligjit që të diskutohen disa çështje që janë kryesore në këtë temë.

E para, cila është metoda e vendimmarrjes në këtë Qeveri? Cili është ndikimi i strukturave joformale parapolitike në të gjithë vendimmarrjen me paratë publike? Cili është ndikimi i politbyrosë së Lëvizjes Vetëvendosje në shpërndarjen e buxhetit të Kosovës? Të zbardhet dhe të shpërfytyrohet njëherë e përgjithmonë niveli më i lartë korruptiv në historinë e Kosovës që ka ndodhur.

A kuptoni që struktura joformale të cilat nuk kanë asnjë rol në Qeveri të Kosovës, nuk kanë funksione publike, sot vendosin për paratë e taksapaguesve të Kosovës. A e kuptoni se përmes një pazari negocimi, mundohet që paraja publike dhe korrupsioni të instalohet si e mirë publike? A e kuptoni që të gjitha veprimet e njëpasnjëshme që ne i kemi diskutuar këtu e që po diskutohen në diskursin publik janë duke shpërfaqur dy konkluzione të cilat secili qytetar duhet ta ketë parasysh. Kjo Qeveri ka ardhur në pushtet me mashtrim. Para katër vitesh ka dhënë platformë politike dhe për ta marrë besimin e atë besim të mos e kthejë në të mirë publike të shtetit, po ta kthejë në të mirë partiake, të njerëzve që s'kanë funksione sikurse është koordinatorja e Lëvizjes Vetëvendosje.

A e kuptoni se ka një aktakuzë e cila e thotë bardhë-e-zi, e zbardh negocimin për një temë e cila do të duhej të ishte temë transparence e diskutimit në Qeveri, jo e diskutimit në zyrë e në kafe? A e kuptoni se Kosova ka ardhur në një stad ku diskutojnë struktura joformale edhe kur duhet të ndalet rryma e kur duhet të shkymet rryma? A ka logjikë që një funksion partiak të ketë ndikim t'i japë udhëzime programore në politikën e Kuvendin e Kosovës? Po është e papranueshme që parapolitika ta ketë nën kontroll secilin ministër të kësaj Qeverie dhe secilën ndërmarrje publike.

Po ndalem vetëm pak te dje. Çka është shpërfaqur dje? Dje është shpërfaqur lidhja që definohet edhe me teorinë e palës kryesore në librat e menaxhimit publik, ku pala kryesore, shefi është një person që e ka emëruar Kryeministri i Kosovës ta menaxhojë krejt jetën e brendshme. Pra,

komunikon me drejtorin e KEK-ut për kur të ndalet e të lëshohet rrugën, dhe për transaksione që lidhen me një shtet tjetër. Ofendon një ish-kryeministër me një gjuhë të rrugës. Këta akademikët, po shpërfaqet se çfarë diskursi dhe çfarë gjuhe të rrugëve e kanë.

Është tepër me rëndësi që sot këtu po ashtu të diskutohet për përlllogaritjen e borxheve të kompanive të ambalazhuesve të ujit dhe të diskutohet saktë dhe të dihet se cila ka qenë mënyra dhe baza e shlyerjes së borxheve. Duhet të jetë tepër e saktë dhe nuk duhet të jetë asnjë paqartësi se mbi çfarë baze është vendosur që kur kompania të caktuara fillimisht është konstatuar borxhi i grumbulluara dhe pastaj të njëjtat kanë pranuar vendime me vlera financiare. Po flasim për vlera milionëshe.

Qytetarë të nderuar të Kosovës,

Ne jemi në dy muajt e fundit të këtij Kuvendi. Edhe fëmijët në djep e di se kur ikën dikush, ikën për shkak se është në faj. Kjo Qeveri dhe kjo mazhorancë janë në faj, se s'kanë si ta mbrojnë në asnjë rrethanë dhe me asnjë mundësi një skandal korruptiv që shihet se është bardhezi. Nuk kanë mundësi ta mbrojnë skandalin me rastin e ushqimit që e diskutuam ditë më parë. Dhe nuk kanë mundësi ta fshehin bashkëpunimin sekret, konfidencial për të cilin kanë qenë me mburrje se s'kanë koalicion me partinë Listën Serbe e në fakt vendimmarrja ka ndodhur mu me ndihmën e tyre.

Nuk mund të dalin në ballë të ballafaqohen, se s'kanë argumente. Kur nuk ke argument mbi në veprim politik, mbi në veprim qeveritar, mbi një proces të ligjbërjes, ikën. Kjo Qeveri do të ikë më 9 shkurt. Do të ikë njëherë e përgjithmonë për shkak se e ka tradhtuar besimin qytetar të njerëzve që kanë besuar në thelb që ndryshimi do të sjellë zhvillim, që ndryshimi do të sjellë shërbime më të mira, arsim më kualitativ, shëndetësi më gjithëpërfshirëse, paga më të larta, pensione më të mëdha, banesa për çifte të reja, pagë minimale më të lartë, mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, mbështetje për strukturat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, mbi të gjitha sovranitet më shumë.

Këta e qitën sovranitetin në fund të pusit me veprimet e tyre. Na shkaktuan, na qitën në probleme me krejt botën. E vendosën Kosovën nën sanksione dhe në kohën kur është sulmuar Kosova më 24 shtator, nuk bënë asnjë veprim ta dekodojnë politikën armiqësore të Serbisë, po u morën me ne, me opozitën, të cilët po duan ballafaqim.

E vërteta do të triumfojë e 9 shkurti do të jetë dita e gjykimit të tyre. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit z. Tahiri!

Tash fjalën ia kaloj deputetes Blerta Deliu-Kodra dhe le të përgatitet mandej Driton Selmanaj dhe pas tij Pal Lekaj.

BLERTA DELIU-KODRA: Të nderuar kolegë deputetë,

Përfaqësues të mediave,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Për mua nuk është fare e pazakontë fakti që transmetuesi publik paska vendosur që këtë seancë me rëndësi të veçantë, këtë seancë të jashtëzakonshme të thirrur prej opozitës, ta bartë në kanal in e tretë. Sepse, dorën e pushtetit, ose më mirë të them thundrën e pushtetit brenda RTK-së, thundrën e Dejonës e plot të tjerëve e kemi parë tash e sa kohë shumë hapur. Kemi parë takime të saj me zv.drejtorin e RadioTelevizionit të Kosovës. kemi parë raportime skandaloze, duke i quajtur mediat e Kosovës si media të cilat financohen nga Serbia. Pra, Radiotelevizioni i Kosovës e ka humbur betejën, me një parti e cila ka instaluar diktat dhe këtë e shohim çdo ditë.

Unë jam e bindur që ata do të jenë të pafuqishëm që t'i fshehin skandalet të cilat po shpërthejnë çdo ditë e më shumë. Edhe nëse këto seanca nuk transmetohen në kanal in e rregullt, para qytetarëve të Kosovës do të jenë të dështuar për t'i fshehur skandalet të cilat kanë shpërthyer në secilin segment të shoqërisë sonë. D.m.th. skandali e mbulon skandalin. Ne kemi një Qeveri që po tenton t'ua mbyllë sytë qytetarëve të dKosovës, duke vendosur që transmetuesi publik të bëhet thundër ose mashë e Lëvizjes Vetëvendosje.

Kolegë deputetë,

Shiheni këtë pamje në mesin e Kuvendit të Kosovës, ku do të duhej të ishin të ulur gjysma e deputetëve të Kosovës, e besa krejt pushteti, e zbrazët. Kanë ikur. Po, po kanë ikur dhe do të ikin deri më 9 shkurt. Edhe a dini pse, të dashur kolegë deputetë? Se po e dinë që e kanë bërë bërllok bash në të tëra anët.

Sepse nuk më as çka të thonë në këtë foltore. Se faktet të cilat sot po i shohim çdo ditë, flasin më shumë se çdo përpjekje e tyre për të thënë se këto që po ndodhin qenkan luftë hibride. E më nuk po mund të rrejnjë.

Në vetvete krejt kjo ikje e tyre është fakti më kokëfortë se ata edhe e ndiejnë veten fajtorë, kolegë deputetë. Të drejtit nuk ikin prej këtu, të drejtit vijnë këtu që të ballafaqohen. Fajtorët, e posaçërisht ata që janë frikacakë i lënë këto ulëse në këtë gjendje para qytetarëve të Kosovës.

Po. U vërtetua që kanë bashkëpunuar me Radoiçiqin në dëm të interesit të Kosovës. U vërtetua se kanë vjedhur me miliona euro përmes mafisë energjetike dhe përmes Martin Berishajt. U vërtetua që përmes faljes ë borxheve me ambalazhues të ujit, dikush i ka fituar diku rreth 400 mijë euro qarkullim bankar vetëm gjatë muajit shkurt. Po i njëjti i ka blerë 4 banesa brenda një viti, dy në Fushë Kosovë, dy në Prishtinë, derisa Qeveria e Republikës së Kosovës ushtrinë e ka lënë pa bukë.

Prandaj, po ikin dhe unë e kuptoj që e kanë të vështirë sot të vijnë e të përballen para këtyre fakteve.

Kolegë deputetë,

Janë dy gra të këtij pushteti, Mimoza Kusari-Lila dhe Dejana Mihali që janë bërë qendër e diskutimeve dhe aferave të mëdha në të cilat ato janë përfshirë. Njëra për kontrollin e zyrtarëve brenda pushtetit dhe brenda Kuvendit, e tjetra për kontrollin e zyrtarëve të pushtetit brenda, e besa edhe jashtë Kuvendit.

Njëra për bashkëpunim me Listën serbe dhe terroristë nga Serbia si Radoiçiqi, e këtu unë sot hiç s'po dua të merrem me deklaratat e saj, as me atë se i thotë dikujt “brate” apo “zemlak” a, dikë tjetër e quan “patetiçki” idiot, idiotin patetik, sepse këto janë fare pa relevancë sot, sepse qëllimi kryesor është dëmi i madh që i është bërë Kosovës dhe i atyre që i kanë lënë gjymtyrët e tyre në luftë.

Dhe, po flas për tjetrën, Dejana Mihalini e cila po dëshmohet se po vendos se kur Kosova duhet të ketë terr, e besa edhe kur Kosova duhet të ketë dritë.

Edhe pse këto të dyja janë gra, janë të vetëdijshme për veprimet e tyre antiligjore dhe antishtetërore, të gjithë ne këtu, por edhe ata atje jashtë që janë duke na përcjellë, duhet ta dinë që këto të dyja nuk kanë vepruar krye në veti.

E kemi thënë, edhe Mimoza edhe Dejana kanë qenë vetëm transmetuese, mesengjere të kryeministrit Albin Kurti. Në një formë ato veç i kanë zbatuar ato urdhra të cilat i kanë marrë nga kryeministri Kurti. Kupola, dirigjenti, kapo e gjithë kësaj strukture të kalbur në esencë, e shumë të dëmshme në veprim, është pikërisht kryeministri i vendit Albin Kurti.

Sikur deputetët e tij tash të cilët janë duke e lypur edhe birën e miut që të ikin, po ikë edhe kryeministri. Sepse në fund të gjithë po arrijmë të kuptojmë edhe ta tash shohim mbretin ashtu siç është në të vërtetë. Po arrijmë ta shohim mbretin, bash cullak.

Të dashur kolegë deputetë,

Po i rendis disa prej çështjeve të përfola ditëve të fundit për ta parë se deri ku ka shkuar kjo Qeveri. A më thoni qysh ka mundësi dikush që e ka rrogën 732 euro në ministri t'i qarkullojë rreth 400 mijë euro brenda një viti? Vetëm gjatë muajt shkurti t'i qarkullojë 400 mijë euro. I njëjti i ka deponuar 100 mijë euro vetëm përmes bankomatit.

Më thoni jua mua, qysh është e mundur kjo, qysh u bë kjo që sistemit bankar të Kosovës dhe inteligjencës financiare t'i ikë një rast si ky?

Qysh ka mundësi që ambasadori i Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj u mbrojt prej krejt shtetit, prej presidentes. Në fund ajo u dorëzuar, po thotë tash që ai duhet të largohet. U mbrojt nga kryeministri, ministrja, të gjithë deputetët e shumicës këtu, ndërkohë që i vetmi persona i arrestuar Nagip Krasniqi e kallëzoi të vërtetën. E pamë në mesazhet në komunikimin me Dejana Mihalini.

Pak a shumë e vërtetë, e tha. Tha Nagipi për shpëlarjen e milionave të Martin Berishajt. Bravo, bre! Bravo! Bile dikush edhe pse pjesë e këtij sistemi të kalbur po e konfirmon që këto para, mjete të shpëlarjes së miliona eurove kanë një bazë dhe janë të vërteta.

Të dashur qytetarë,

A e patë se ku kishin komunikuar Dejana me Nagipin? Në një aplikacion sekret. Dhe, kjo shton edhe më tepër dyshimin se çfarë po ndodh me këtë Qeveri.

A po e shihni se çfarë strukture e fshehtë është e ndërtuar prej këtij pushteti që juve qytetarë të Kosovës të provojnë t'ju mbajnë larg realitetit. Qysh ka mundësi që shumica prej zyrtarëve të këtij pushteti janë zënë me keqpërdorime milionëshe, ndërsa ushtarët tanë i kemi pa bukë. Ushtarët tanë i kemi pa çizme. Njësinë Elitare e kanë qitur në rrugë, ndërkohë që veteranët i kanë vendosur në kushtet të padinjitetshme.

Qysh ka mundësi që nëpër të gjitha konkurset publike janë familjarët e tyre të cilët marrin pozita në institucionet e Republikës së Kosovës, e ka të tjerë të cilët aplikojnë me dhjetëra herë e nuk arrijnë që ta kenë një vend pune në Kosovë? Qysh ka mundësi që u jepen kështu haptas qindra-miliona euro kontrata njëburimore dostave e askush nuk vjen këtu të japë asnjë llogari?

Qysh ka mundësi që po vërtetohet se kanë vjedhur edhe bukur, kanë vjedhur edhe zejtin, e prapë asnjë fjalë. A jeni duke parë se çfarë janë duke thënë tash? E kanë mësuar një fjalë e po mundohen të thonë që krejt kjo çka po ndodh qenka një luftë hibride.

Çohet gjenerali i FSK-së deklarohet që ushtarët e Kosovës nuk kanë bukë. Çka thotë shumica? Kjo është luftë hibride. Çohet Mimoza Kusari dhe deklarohet, mesazhet, përgjimet të cilat i kemi dëgjuar ku ajo ka komunikuar me Radoiqiqin, kryeministri thotë se nuk e di se çka ka folur, por kjo është luftë hibride.

Kjo është veç një përpjekje e zbehtë që të provohet të ndërrohet realiteti, sepse nuk kanë çka flasin. S'ka luftë hibride këtu. Këtu ka vetëm luftë kundër shtetit të Kosovës. Luftë kundër interesave të qytetarëve të Kosovës. Luftë kundër institucioneve të këtij vendi. Pra, këtë luftë po bën një parti. Po e bënë Lëvizja Vetëvendosje, kryeministri Kurti, Mimoza Kusari-Lila, Dejana Mihali, martinat, ragipat, plot e plot të tjerë të cilët i kemi parë së fundi deri ky rasti i fundit me çështjen e ujit që u diskutuar paraprakisht nga zoti Shala.

Prandaj, kolegë deputetë, sot më shumë se kurrë faktet janë kokëforta dhe sado që ky pushtet provon të thotë që është luftë hibride, sado që ky pushtet provon që transmetuesin ta mbyllë për këtë seancë të jashtëzakonshme, janë faktet që do t'jua tregojnë fytyrën e vërtetë këtyre njerëzve. Unë jam e bindur që 9 shkurti do të jetë demonstrimi më i mirë i këtij pushteti që sot e ka lënë këtë Kuvend në këtë gjendje dhe që qytetarët i kanë braktisur se e thashë, hallin e kanë te milionat, hallin e kanë te dejonat, e hallin e kanë edhe tek udhëzimet të cilat i marrin nga kryeministri Kurti për të dalë e për t'i transmetuar në secilin institucion të rëndësishëm të cilit po tentojnë t'ia vënë drynin.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën ia jap deputetit Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Shumë i nderuari nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara kapela të zeza,

Është në vazhden e seancave të jashtëzakonshme që jemi detyruar t'i thërrasim e të diskutojmë për çështje shumë të rëndësishme që po ndodhin dhe po shpërfaqen ditëve të fundit.

Dua t'jua them një gjë që Lëvizja Vetëvendosje gjithmonë në të kaluarën Kuvendin e Kosovës e ka parë si arenë për të bërë fushatë politike. Si arenë për të dëshmuar forcën e vetë. Si arenë për të bërë propagandë politike. Si arenë për të promovuar edhe idetë e mbrapshta, ndoshta, për Kosovën, po e ka shfrytëzuar këtë Kuvend. Dhe tash, po ikin prej Kuvendit.

Pyetja shtrohet: Pse po ikin prej Kuvendit? Unë jam i bindur për këtë; janë koritur me fund. Këta s'kanë fytyrë më që të vijjnë. Këta s'kanë fytyrë që të ballafaqohen, sepse duke i njohur disa prej deputetëve, sidomos disa ish-veteranë të luftës dhe disa persona që së paku kam njëfarë vlerësimi që kanë integritet, unë jam i bindur që ata nuk duan as të vijjnë këtu, nuk duan as t'i shohin disa prej kolegeve dhe kolegëve të vet që janë përfshirë në këtë proces.

Unë jam i vetëdijshëm që çështja e zotit Hafizi ose çështja e Ministrisë së Ambientit, është çështje tash që është në dorë të organeve të drejtësisë. Dhe, absolutisht nuk pretendoj ose nuk provoj që të flas që në njëfarë forme mund të interferojmë edhe në procesin e organeve të drejtësisë. Por, më 25 prill të këtij viti, unë këto fjalë që sot në fakt po dëshmohej, jo sot, por këto ditë, me arrestimin e Naser Hafizit, unë i kam thënë në këtë Kuvend dhe u kam bërë thirrje organeve të drejtësisë që të vihen në lëvizjes, sepse kemi një skemë të organizuar korruptive me elemente shumë të qarta kriminale, dhe ashtu doli.

Liburn Aliu në atë kohë thoshte është shpifje. Tregonte disa formula të përlllogaritjeve të borxheve që veç ai dinte të kamuflonte, por në fakt, e vërteta nuk mund të kamuflonet. Ajo që duhet t'u bëjmë thirrje në sot organeve të drejtësisë është që të mos ndalen veç me Naser Hafizin.

Naser Hafizi është instrument i realizimit të skemës të korrupsionit të strukturuar që Lëvizja Vetëvendosje ka vendosur ta aplikojë në Kosovë.

Vjedhja ose përfshirja në këtë mega skandal, ku prek 90 milionë euro borxhe dhe që është provuar që me disa qindra-mijëra euro të mbyllet, nuk është krejt e rastësishme. Është skemë e organizuar kriminale. Unë jam i bindur që këtu është i përfshirë drejtpërdrejt Albin Kurti.

Nuk ka asnjë mundësi që Liburn Aliu e Naser Hafizi t'i bëjnë këto pa lejen e Albin Kurtit, sepse Albin Kurti ka qenë i informuar nga sinjalizuesi me e-mail çka ka ndodhur dhe pse po ndodh. Dhe, ai s'ka ndërmarrë asnjë veprim, përkundrazi, krejt çka kemi dëgjuar ne, ka dalë t'i mbrojë.

Unë e kam edhe aktakuzën e prokurorisë këtu, që përpos që...Këtu po del që ky Naser Hafizi, për faljen e borxheve është vetëm njëra nga veprat penale që ai e ka, por veprat e tjera penale nuk lidhen fare me këtë rast. Lidhen me shpëlarje parash. Lidhen me mos-deklarim të pasurisë.

Vetëm si pretekst ne kemi nisur këtë çështjen e faljes së ambalazhuesve dhe më pas dalin edhe probleme të tjera kaq masive. Dhe, çka shpërfaqë në fakt ky rast? Unë mendoj shpërfaqë disa aspekte. E para është që dyshimet tona për korrupsion të strukturuar në këtë Qeveri po konfirmohen. Domethënë, krejt kjo Qeveri është e zhytur në korrupsion, jo disa ministri.

Thashë dhe janë fakte më që zoti Kurti është dijani për aferën me Martin Berishajn me tregtimin me energji. Zoti Kurti është në dijani për Nagip Krasniqin. Zoti Kurti është në dijani për ambalazhuesit e ujit. Zoti Kurti është në dijani për rezervat shtetërore, e në fakt ka dalë që t'i mbrojë me ortodoksizëm këto, i bie që regjisori, ose ndërtuesi i kësaj skeme të korrupsionit të strukturuar në Kosovë, është vetë ai.

E para, dyshimet tona po konfirmohen. Nuk janë më dyshime të bazuara, të themi jo vetëm ne po mendojmë. Jo, jo tashmë kemi bazë të mjaftueshme që kjo Qeveri dhe kjo mazhorancë kanë korrupsion të strukturuar në Kosovë.

E dyta çka ka shpërfaqur kjo është që sistemi i vendimmarrjes në Kosovë nuk është bazë të rendit tonë kushtetues dhe sistemit demokratik që e kemi ndërtuar ne. Sistemi i vendimmarrjes në Kosovë është zëvendësuar me nivelin e parapolitikës.

Kur në vendimmarrje ka peshë kryekrimineli Radoiçiq, kur në vendimmarrje ka peshë një person krejtësisht jashtë institucioneve, Dejona Mihali, këtu më s'po flasim për vendimmarrje kushtetuese me mandat kushtetues, por po flasim për vendimmarrje të një sistemi parapolitik, e që ky është i rrezikshëm, jo vetëm për demokracinë, por është i rrezikshëm për vendin.

E treta çka kanë nxjerrë këto rastet e fundit është, çka në fakt mendon Lëvizja Vetëvendosje për shqiptarët dhe partitë e tjera në Kosovë. Nëse këta mendojnë që Isa Mustafa dhe LDK-ja qenkan horra e Simiqi qenka brate qenka vëlla, këtu është problem serioz, të nderuar njerëz që po na shikoni. Nëse, po them edhe njëherë, Isa Mustafa dhe LDK-ja qenkan horra e Simiqi qenka vëlla, kush janë këta njerëz këtu?!

A e keni parë, në momentin kur ne flasim për këto fenomene, këta dalin e thonë, këta janë të Serbisë, këta janë me Serbinë, a në fakt shumë gjëra lidhen, kështu po them, hajt t'i analizojmë. Pse Nagip Krasniqi merr para prej GEN-it të Serbisë? Pse dje e pardje doli në media që ky Naser Hafizi paska edhe shtetësi të Serbisë? Nuk e di! Po them, në media e pashë.

Pse konsultohen këta me një kriminel që ndiqet nga SHBA-ja? Pse këta e quajnë vëlla një serb? A janë të rastësishme këto? Hajde po ju them, vendosni ju, mendoni ju. E ndërkohë, të fyhen shqiptarët, të fyhen kolegët shqiptarë, të fyhen njerëzit që kanë dhënë shumë kontribut për këtë vend qenka shumë e lehtë, qenka shumë e thjeshtë.

Unë mendoj që kjo na qet në një rrafsh krejtësisht tjetër e që duhet vërtet të reflektojmë.

Të mos harroni, kjo çështja me Serbinë. Ju kujtohet kur ishte kolegu im, ish-kryeministri Hoti, me një fjalë të vetme, “razumem”, e pati përmend, krejt Lëvizja Vetëvendosje janë çuar në këmbë i madh dhe i vogël për ta fyer kryeministrin Hoti, LDK-në, shihet ti çka flet ky, “razumem”.

E këta i quajnë “brate”. Këta me dashur del kryeministri flet më rrjedhshëm gjuhën serbe se gjuhën shqipe, duke glofikuar figurën si Oliver Ivanoviqi, si Zoran Gjingjiqi. Domethënë, për kriminelë këta glorifikojnë, këta flasim me dashuri, por kur vjen puna tek oponentët e tjerë politikë, një fjalë e vetme shfrytëzohet për të bërë fushatë linçuese ndaj njerëzve pse janë patriotë të këtij vendi. Pse e duan këtë vend dhe pse punojnë me ndershmëri për këtë vend. Kjo është klasa politike që 51%-shi e ka votuar.

Prandaj, të nderuar njerëz që po na shikoni, është momenti i fundit unë mendoj që të reflektojmë, ta shohim se në çfarë gjendje kemi ardhur si shoqëri. Kë e kemi në krye të vendit. Kush na qeverisë. Dhe, cila është qasja e tyre.

Kanë ardhur me dy narrativa në pushtet; kinse janë nacionalistë, kinse e duan këtë vend, dhe koha po e dëshmon që më së paku ka nacionalizëm dhe patriotizëm tek ta. Të gjitha veprimet, edhe në raport me dialogun me Serbinë dhe me marrëveshjet që i ka nënshkruar janë krejt e kundërta e asaj narratives që e kanë bërë.

Pastaj kanë thënë, ne jemi të pakorruptuar. Ne jemi shtresa më e mirë e kësaj shoqërie. Tash po na del që këta janë shtresa më e lig e kësaj shoqërie. Këta janë në gjendje të gllabërojnë gjithçka në këtë vend. 2 mijë 123 kontrata sekrete, aksham pazari. Kjo nuk flet pastaj vetëm për një ministri, për të gjitha ministrinë.

Mediat, duke iu falënderuar mediave, po shfrytëzoj rastin për të dytën herë, ata na kanë ndihmuar shumë që ne të vijmë deri te këto konkluzë që ka hajni të strukturuar në KEK. Ka hajni në tregtinë me energjinë. Ka hajni te rezervat shtetërore. Ka hajni edhe tek ambalazhuesit e ujit.

Unë jam i sigurt, në secilën ministri që prekim del ky korrupsion i strukturuar. Sepse 2123 kontrata janë në krejt Qeverinë, në krejt ministrinë. Nuk është asnjë ministri immune ndaj fenomenit të krimit dhe të korrupsionit. Këta ishin të pangopshëm në vjedhjen e parasë publike, na abuzimin e parasë publike. Këta nuk po ditkan kur është boll. Këta nuk po ditkan kur është fundi. Kanë menduar që duke mashtruar dhe duke fyer, i kemi fituar 51%, i mashtrojmë edhe institucionet e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, edhe një minutë!

DRITON SELMANAJ: E mashtrojmë edhe popullin edhe një herë, sepse të vihet në stad ku fsheh kurrjë as me sms as me e-mail as me kurrjë. Këta kanë një vetëbesim që janë mbi këtë vend. Janë mbi institucionet. Janë mbi rendin juridik dhe kushtetues. Janë mbi gjithçka. Këta neve nuk po na trajtojnë si parti politike, as si njerëz të zgjedhur.

Popullin s'po e trajtojnë si një popull të dinjitetshëm. S'po e trajtojnë si një popull që di të reflektojë dhe të vendosë dhe të vlerësojë, por po mendojnë që i gjithë populli dhe e gjithë shoqëria janë në shërbim të një kaste të vogël, po që në fakt hajninë e kanë në gjene. Veprimin antikombëtar e kanë në gjene. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Selmanaj! Tani ia jap fjalën deputetit Pal Lekaj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Media të nderuara,

Dejona sot e ka ndalur transmetimin në RTK, në televizionin publik që financohet nga Kuvendi i Kosovës dhe i përgjigjet vertikalisht Kuvendit të Kosovës. Dejona nuk di si s'e ka ndalur edhe energjinë sot këtu në Kuvend. Dejona nuk di se si nuk e ka ndalur edhe ngrohjen në këtë

Kuvend, por i themi Dejonës dhe kryeministrit Kurti që të gjitha mund t'i bëjë, por u ka hyrë uji për fundi dhe nuk di kah do t'i dërgojë.

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot po përballemi me një nga skandalet më të rënda të qeverisjes Kurti, falja e borxheve të ambalazhimit të ujit. Një manovër që i ka kushtuar buxhetit të Kosovës rreth 10 milionë euro. Për ta bërë këtë, ministri Liburn Aliu dhe vartësit e tij bënë marrëveshje sekrete që të përfitonin vetë dhe të afërmit e tyre. Kjo nuk është thjesht një vjedhje, është një grabitje e drejtpërdrejtë, një manipulim i sofistikuar që dëmton rëndë qytetarët e Kosovës. Po, falje borxhesh jo vetëm që pasurohet një rreth i ngushtë i pushtetit, por njëkohësisht braktisen qytetarët që përballen me mungesë të ujit të pijshëm.

Prishtina, shumë qytete e tjera janë të mbetura në krizë të vazhdueshme të furnizimit me ujë cilësor dhe ndërsa qytetarët tanë nuk kanë ujë për të pirë, pushteti bën pazare për të fituar në kurriz të tyre. Kjo është një qeveri që u shndërrua nga premtime për të luftuar krimin dhe korrupsionin, në një model të vjedhjeve klasike dhe keqpërdorimeve të vazhdueshme.

Në vend që të mbajnë premtime, ata janë zhytur në krim dhe kanë pasuruar vetëm interesat e tyre dhe interesat partiake. Qeveria Kurti me këtë skandal ka humbur çdo besim, ata janë përgjegjës jo vetëm për vjedhje, por edhe për shpërfilljen e plotë të interesave të qytetarëve, të cilët vazhdimisht janë mashtruar dhe shfrytëzuar nga kjo qeveri dhe vetë kryeministri Kurti. Sot nga ky Kuvend kërkoj që kryeministri Kurti dhe ministri Aliu dhe vartësit e tij të hetohen nga organet kompetente e të dalin para ligjit dhe të përgjigjen për këto skandale. Ata duhet të japin llogari për çdo euro të vjedhur dhe për çdo familje të varfëruar nga keqmenaxhimi i tyre. Ky skandal është dëshmi se Qeveria Kurti ka thyer shpresat e popullit të Kosovës, koha është që qytetarët të kuptojnë të vërtetën dhe të kërkojnë drejtësi për çdo keqpërdorim, sepse për të mirën e këtij vendi një qeveri e tillë duhet të përgjigjet dhe të dënohet për tradhti ndaj popullit që e solli në pushtet.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, për procedurë? Po, deputeti Armend Zemaj për procedurë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të gjithë e dimë që Radiotelevizioni i Kosovës është transmetues publik, i themeluar dhe i financuar nga Kuvendi i Kosovës, që nënkupton duhet t'i përgjigjet publikut, e jo individit, e më së paku parapolitikës.

Ne jemi të njoftuar që nuk ka transmetim të kësaj seance në programin qendror të saj, kjo do të thotë mbyetje të demokracisë edhe tentim që të mbytet zëri i deputetëve që i bie përfaqësuesve të qytetarit të vendit. Si grupe opozitare i ftojme mediat këtu që janë të pranishme dhe që na

dëgjojnë, që të gjithë së bashku në orën 14:30 do të shkojmë në Radiotelevizionin e Kosovës dhe t'i dorëzojmë fjalimet tona. Ne që folëm dhe nuk na dëgjuan, ose së paku vetëm përmes mediave të pavarura që janë këtu dhe të gjithë kolegët e tjerë që kanë përgatitur dhe kanë të drejtë fjalë për shqetësimet, të cilat janë ngritur në thirrjen e kësaj seance kuvendore. Andaj, ju ftoj të gjithëve që të na bashkëngjithni në 14 e 30, shefat e grupeve parlamentare do t'iu adresohen edhe qytetarëve para Radiotelevizionit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Në rregull! Faleminderit! Atëherë, vazhdojmë sipas radhës, fjalën e ka deputeti Haki Abazi.

HAKI ABAZI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Media,

Për të vazhduar aty ku e la deputeti Zemaj, ju kujtohet në votimet e fundit të deputetëve për Bordin e RTK-së, Lëvizja Vetëvendosje me orkestrimin e Dejana Mihailit i kishte dhënë 30 poenë kandidatit serb dhe 5 poenë doktorit të shkencës, e cila ishte femër, kandidate për të vazhduar mandatin në Bordin e RTK-së, zonjës Shukrie Rama.

Domethënë, nuk janë të rastësishme kur ne këtu ekspozojmë këtë lloj të kontrollit të institucioneve të rëndësishme, në këtë rast të Bordit të RTK-së, sepse një Bord i RTK-së plotësisht i kontrollueshëm, plotësisht jo me kurriz, lejon që të bëhen këso lloj makinacione të veprimeve, të cilat kontrollohen nga jashtë institucionit. Do të thotë, nuk di se çfarë tjetër duhet të ndodhë për të parë që vendimmarrja është dalë jashtë institucioneve. Vendimmarrja nuk ekziston përbrenda rregullit, ligjit, procedurave të aprovuara nga institucionet legale të shtetit. Unë i bëj thirrje prokurorisë që të shohë afër e të marrë në pyetje prapë zonjën Mihaili nga përgjimet që kanë dalë, sepse të jeni të bindur që edhe kjo puna e ujit, kushdo që përmendet aty, qoftë Nagipi qoftë ai tjetri, janë veprime të kushtëzuara, përndryshe nuk je pjesë e kësaj strukture. Do të thotë, forma të orkestruara të kontrollit nga makinacionet dhe mashat e Kurtit.

Kështu që kur kam folur para 2-3 vjetëve për çështjen e Dejana Mihailit dhe më duket zonja Musliu nga PDK-ja kishte ngritur pyetje pse duhet të jetë ajo pjesë e takimeve zyrtare në Shqipëri, shumica e njerëzve konsideronin që kjo është vetëm kështu përballje fjalësh. Jo, kjo është fyerje e dhunim i përfaqësimit qytetar, është mungesë totale e veprimit demokratik të institucioneve, rrjedhimisht kemi ardhur në pikëpyetje të asaj që quhet “transparencë, besim ndaj Qeverisë, mirëqeverisje, llogaridhënie dhe përgjegjshmëri”, që janë pjesa kryesore e të qenët qeveri demokratike. Dhe, fakti që sot vazhdojnë të mos jenë prezentë këtu, qytetarë të nderuar, sado që ndonjëri prej juve jeni ulur aty me urdhër për të sharë në Fejsbuk, e të krijoni situata të paqena, duhet të kuptoni drejtpërsëdrejti që aty është një urdhër i vetëm, “mos shkoni në Kuvend, se po ia mbani debatin opozitës”.

Kjo është fjalia me të cilën çdo deputet i Lëvizjes Vetëvendosje goditet drejtpërsëdrejti me kërcënimin që nëse shkon, nëse bëhesh pjesë e debatit, nëse i paraqitesh mediave për t'u përballur me qytetarët dhe mediat, apo edhe qoftë në një debat ndërpolitik, mes partive politike, i bie që ti ose ajo nuk mund të jesh pjesë e listës së Lëvizjes Vetëvendosje. Ky është përfaqësim me shantazh, kjo është fyerje e rregullave të demokracisë që deputeti ose deputetja ka të drejtë të ketë mendim të pavarur ose së paku duhet të lejohet diku një platformë me të cilën idetë, konceptet, kundërshtitë mund të paraqiten, sepse vetëm në komunizmin sllav nuk ka ekzistuar mundësia të jesh deputet që ke të drejtë fjale, ose ke të drejtë mendimi, ose që mund të kesh mendim ndryshe. E, nëse ne jemi duke jetuar në të '60-'70-at, atëherë ta shohim se si realisht do të duhet të funksionojnë demokracia në vitin 2024 këtu tek ne.

Tani më duhet të them që logjika e fyerjes, e denigrimit të Parlamentit vazhdon edhe jashtë. Ministri i Financave mbrëmë shkruan një postim, duke i quajtur të gjithë deputetë “ushunjëza” që po lemerisin e ulërinin, sepse kinse kjo qeveri qenka duke e luftuar krimin edhe korrupsionin. Cilin? Në ministrinë e Liburn Aliut që jep në mënyrë jotransparente subvencione dhe lanë borxhe të operatorëve të ujit. Apo në komunikimin e Dejonës me Nagipin që merr edhe vendime arbitrare aty për aty për çështjen e sektorit të energjisë që janë më të rëndësishme. Apo, në skandalin e fundit me FSK-në, ku një vajzë, me krejt respektin, që s'e ka kryer as shkollën e mesme si duhet, flet për çështjet e Ministrisë së Mbrojtjes, sepse është spiuni i Dejona Mihailit në Ministrinë e Mbrojtjes.

Do të thotë, në çdo ministri ekziston një individ i cili nuk i përgjigjet ministrit, qeverisë, rrjedhimisht nuk i përgjigjet komisionit parlamentar, por i përgjigjet një strukture jashtë institucionale atje dhe bart mesazhin dhe krijon diskursin publik, të cilin ia përcakton dikush jashtë institucioneve. Kjo është për brengosje, sado që mund të jesh militant politik, sado që mund të marrësh para prej klikimeve të grupeve të Fejsbukut, kjo është për brengosje dhe unë duhet ta thërras prapë prokurorinë që makinacionet që prodhojnë lajme të rrejshme dhe që krijojnë diskurs publik bazuar në interesa politike të Kurtit duhet ndjekur, se ndryshe nuk ka mundësi, nuk është kjo fushatë elektorale, ky është degradim i demokracisë, nuk kemi nevojë hiç të shkojmë në zgjedhje nëse kjo është forma e funksionimit të institucioneve.

Më së paku sot do të duhej të ishin këtu prezent për t'i bërë nderime gjeneralit Xheksion, i cili kishte bërë hyrjen e parë të forcave të NATO-s në Kosovë. Së paku ky është vendi ku duhet kryeministri dhe Parlamenti i Kosovës të bëjnë nderime institucionale, jo Fejsbuku, me Fejsbuk nuk mbahet shteti, me përralla nuk mbahet shteti, unë e di që dikujt ka mundësi që i duhet shumë më shumë kohë për të kuptuar, por realiteti nga këtu, nga brenda, jo nga manipulimet atje, por nga këtu është më i zi se këto kapelat që janë vendosur këtu. Për besë është jashtëzakonisht e pabesueshme në cilin nivel kemi mbërritur, tash nëse është ideja të sabotohet puna e Parlamentit deri në zgjedhjet e ardhshme, i bie që realisht ata po mendojnë që nuk ka se çfarë të diskutohet këtu dhe qytetarët duhet të presin për tre muaj që të vijë një fushatë, ku bëhen gënjeshttrat e

radhës, kauzat e rrejshme për të dalë për të votuar. Po, e vërteta, realiteti nuk ndërtohen në fushatë elektorale. E vërteta e realiteti është jeta e përditshme që qytetarët e kanë përballë.

Tash, sigurisht që fjalimet janë e vetmja formë demokratike për të shfaqur mendimin politik këtu, por ata duhet të kuptojnë që Mimoza Kusari nuk ka vend më në këtë Parlament. Ajo mund të ketë vend vetëm në ulësen e gjykatores, ku duhet të gjykohet për tradhti kombëtare, një herë ka gënjyer që nuk ka fol me Radojçiqin, mandej ka folur shkurt me Radojçiqin, tash i bie që e gjithë kërkesa për Listën serbe ka ardhur nëpërmjet saj për të ardhur dhe për të votuar ligje, buxhetin, përkrahje të shumicës në kohën kur i ka goditur deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje. Paramendojeni, domethënë për këtë mazhorancë ose duhet të jesh shqiptar i vdekur në varr, për t'i sjellë do lule të jesh i mirë ose duhet të jesh jashtë mundësisë për të ndikuar në politikë.

Në momentin kur je gjallë ose në momentin kur je me kapacitetin për të ndikuar, atëherë devijimi shkon edhe kërkojnë ndihmë prej Listës serbe. Krejt ne mundemi me qenë të këqij këtu që jemi, pozitë, opozitë, unë i pavarur, Fatmir Humolli me mendjen dhe idenë e tij, ama të lypësh ndihmë prej një shkau, krye kriminel, krye terroristi Radojçiqi dhe t'i shkelësh deputetët shqiptarë këtu, i bie që realisht këta janë përnjëmend në të "60-at. Kur kanë qenë shqiptarët komunistë të devotshëm edhe bashkë me serbët e Beogradit i kanë ndjekur njerëzit ku janë e ku s'janë për veprimtari kombëtare, kjo është, bashkëpunim me Radojçiqin për t'i shkelur deputetët shqiptarë të Parlamentit të Kosovës. Nuk ka se si të shpjegohet ndryshe, po ju them shumë hapur që sa kam qenë anëtar i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje ky ka qenë mentaliteti, ose bën çfarë po të themi, që janë gabim, diskriminim, qoftë për Gjykatën Kushtetuese qoftë për Bordin e Drejtorëve, ose ti je kundërshtar yni.

Rrjedhimisht, pason përjashtimit. Ky mentalitet është vetëm kur ti sigurohesh që ke vota të mjaftueshme, e votat e mjaftueshme i ka lypur prej Simiqit edhe Radojçiqit.

KRYESUESI: Edhe një minutë, regjia ju lutem!

HAKI ABAZI: Unë nuk dua që të ik nga kjo foltore tani pa thënë edhe një herë që ju mund ta konsideroni fushatë elektorale, aspak interes elektoral nuk kam, por ku është futur vendi me këtë mentalitet e me këtë mendësi, është më keq se sa ajo që është kritikuar në të kaluarën. Sepse, së paku institucionet kanë funksionuar, së paku vendimet janë marrë qoftë në nivel të kryeministrit hapur, ose me komisione parlamentare funksionale.

Sot, as njëra, as tjetra nuk funksionon, është jashtinstitucional vendimi, janë jashtëkushtetuese vendimet me të cilat është duke u ballafaquar ky vend dhe nuk mund të lejojmë që institucioni më i lartë i këtij vendi, Parlamenti, të jetë i heshtur përballë vendimeve, të cilat merren jashtë institucioneve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Abazi! Para se t'i jap fjalën deputetit të radhës, duhet t'ju tërheq vërejtjen për një cilësim, për një shkarje, pra duhet të përdorim emërtime të tjera, pra serbë të themi, jo ashtu si e përdorët ju.

Faleminderit!

Tani radhën e ka deputeti Xhavit Haliti.

Regjia, ju lutem, ia mundësoni zotit Haliti të flasë.

XHAVIT HALITI: Faleminderit, zoti kryetar i seancës, faleminderit për fjalën,

Zotërinj deputetë,

Zotërinj kapuçë të zinj ose zotërinj me kapuçë të zinj,

Të dashur qytetarë dhe media,

Tani ne kemi kaluar faza të ndryshme në këtë Parlament, dhe më kujtohet që një fazë kur ne në Kryesi duhej t'i mbanim maskat e gazit rezervë për t'u mbrojtur nga një grup parlamentar, i cili nuk ishte në gjendje që të përballej me pozitën atëherë, me argumente, por donte ta dëbonte nga Parlamenti për të mos e lejuar që të marrë vendime në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet, por duhej me çdo kusht t'i dëgjonte opozitën e atëhershme, e cila ishte pa kapela të zeza dhe ishte ka kravata dhe tani i kanë vendosur edhe kravatat ose kollaret, siç themi.

Më kujtohet edhe një seancë kur e organizuam atëherë me kryetarin e Kuvendit që t'i përfundojmë pikat e rendit të ditës dhe ata s'donin të na lejonin, na goditshin me ujë, me vezë, me gjithçka që mundën, por fatmirësisht edhe nën presionin e gazit, e ujit, edhe sharjeve e filikaqave e fyerjeve, ne e patëm përfunduar atë seancë dhe duhej të ndërronim vend derisa e vendosëm një flutur atje për ta nxjerrë gazin lotsjellës që e hidhnin çdo ditë në seancat e kohës së kaluar.

Tani, ne kemi një opozitë besoj të arsyeshme, një opozitë që rri në Kuvend, që po ofron gatishmërinë të debatohet me pozitën, por këta fatkeqësisht, arsyet nuk i di, sepse s'kanë ndonjë presion, por sot po përfaqësohen nga kapelat këtu dhe nuk vijnë në sallë për t'i kryer detyrat e veta, të përballen edhe me çështjet e vështira, në qoftë se i konsiderojnë ata të vështira. Por, edhe në qoftë se i konsiderojnë si të pavërteta këto që po i ngre opozita, e kanë mundësinë këtu për t'i thënë.

Po, këtu ekziston krejt diçka tjetër, si duket, deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje s'mund të flasin vetë pa qenë shefi i tyre dhe nuk e di a është kthyer nga udhëtimi që e ka pasur këto ditë, elektorale edhe politik, dhe dua të them që tendenca e veprimeve të tilla është jo për ta pasur një republikë parlamentare, por për ta instaluar një republikë qeveritare, në krye të së cilës është një diktator që s'pyet për njeri dhe repartin e tij të deputetëve e ka sa për të votuar, ose rivotimi kur ka nevojë. Tani, po flasim për disa skandale, të cilat edhe mund të kenë ndodhur, por në qoftë se s'kanë ndodhur, pse s'vijnë të tregojë që s'kanë ndodhur. Është krejtësisht normale të ballafaqohet opozita me diçka që ndoshta është e lajthitur për një moment. Pse s'vijnë?

Unë pata disa reagime sa u përket bisedave të zonjës Kusari me atë personin Radojçiq, dhe më thanë që këto janë regjistrime me inteligjencë artificiale dhe ma dërguan bile një bisedë të cilën e kishin konvertuar, duke diskutuar kjo zonja Kusari rusisht. Mirëpo, ajo mbrëmë e pranoi vetë që ka biseduar me zotin Radojçiq dhe sa ka biseduar, unë prapë s'mund të them. Dhe, tani lind pyetja: a është përgjegjësi penale të bisedojë dikush me dikë? Politikisht mendoj që në momentin kur ai ish- kryetari i Partisë Lista serbe ka hyrë në listën e zezë të SHBA-së, nuk do të duhej askush të komunikonte me të. Interesat politike të secilit janë interesa politike, por përgjegjshmëria prapë duhet të bëhet në përputhje me ligjet e Kosovës, me Rregulloren e Kuvendit dhe me të drejtën kushtetuese.

Pra, unë apeloj te të gjithë që Kuvendi është institucioni më i lartë i shtetit, i vendit dhe si institucion duhet mbështetur, duke përfshirë këtu edhe Televizionin e Kosovës, i cili sot s'paska pasur vend në programin e parë të tij për ta transmetuar seancën e sotme, por dihet që Radiotelevizioni i Kosovës financohet me votimin ose me buxhetin që i ndahet nga Kuvendi i Kosovës.

Prandaj, të gjitha këto veprime të Vetëvendosjes krijojnë shije të hidhur jo pse po përpiqen ata për gjoja të thënë se s'është gjë kjo puna e kësaj a asaj seance, po lë shije të hidhur se si ka mundësi që qytetarët e Kosovës të votojnë për një grup njerëzish, të cilët janë të gatshëm ta lënë Parlamentin e Kosovës, ose mikrofonat e vet, me kapela të zeza të varura në to. Për çka? Sepse shefi u ka thënë që pa ardhur unë në seancë, ju s'mund të shkoni dhe nuk mund të votoni për asgjë pa qenë unë aty, ose pa ju urdhëruar unë.

Të gjitha këto, duke i përfshirë edhe kjo Dejona, bile unë Dejonën mendoj si shumë po e përmendim. Po besoj ajo e ka marrë si këshilltare, edhe ndoshta është në rregull të merret një këshilltare nga Shqipëria, edhe nga ndonjë vend tjetër. Ne kemi pasur edhe kemi këshilltarë edhe nga vendet perëndimore, por përgjegjësitë dhe autorizimi nuk është i saj, është e Albinit, sepse ajo është këshilltare e Albinit dhe mund ta ketë marrë ndonjë detyrë për ta kryer.

Uroj që përgjegjësitë të kërkohen aty ku është vendi dhe jo te ata që nuk kanë ndonjë përgjegjësi dhe ndonjë mundësi për të marrë vendime. Vendimet i merr Qeveria dhe Qeveria si e tillë duhet të jetë e përgjegjshme që të jetë prezentë me krejt ministrat këtu, bashkë me Albinin. E paska qitur kapuçin këtu, unë s'po i qes ujë në kapuç, por po e thërras që të vijë në seancat e radhës në Parlamentin e Kosovës.

KRYESUESI: Tani ia jap fjalën deputetes Albana Bytyqi. Valentinë, a je tërhequr apo si? Një minutë. D.t.th. e ke tërhequr? Atëherë, Valentinë, e ke fjalën.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: Faleminderit, nënkryetar!
Kolegë deputetë,

Qytetarë të respektuar të Republikës së Kosovës,

Arrestimi i dy zyrtarëve të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës sipas Prokurorisë, ka të bëjë direkt me faljen korruptive të ambalazhuesve të ujit. Nuk bëhet fjalë për zyrtarë të thjeshtë të Ministrisë së Mjedisit, por është arrestuar dhe paraburgosur vetë zëdhënësi i udhëheqësit të Autoritetit të rajonit të pellgjeve lumore në Ministrinë e Mjedisit me dyshimin për keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar. Kjo i bie shpëlarje të parave dhe mosraportim apo raportim i rremë i pasurisë në të ardhura, si dhe Sekretari i Ministrisë apo thjesht ushtruesi i detyrës, sepse edhe ashtu të gjithë janë ushtrues detyre dhe po funksionojnë me ushtrues detyre.

Sipas Prokurorisë, janë tejet të rënda dhe penale këto vepra që kanë prekur direkt buxhetin e Kosovës, rrjedhimisht, edhe dëmtimin e vetë qytetarëve, sepse me ato mjete financiare do të mund të kishim shumë më shumë investime kapitale për qytetarët e Republikës së Kosovës. Akuzat janë për korrupsion të paparë në Republikën e Kosovës, ku është abuzuar me miliona euro, të cilat do të ishin për të mbushur buxhetin e shtetit, e jo kuletën e individëve e jo të militantëve të Lëvizjes Vetëvendosje.

Sipas raportimeve të deritashme, vetëm për pesë kompani të ambalazhuesve të ujit janë keqpërdorur 11 152 144 euro nga buxheti i Republikës së Kosovës. Në bazë të dosjes së Prokurorisë, zyrtari i ngritur në detyrë të re me ardhjen e ministrit Aliu në krye të Ministrisë së Mjedisit, jo vetëm që paska nënshtetësi të Serbisë dhe atë shpesh e paska vizituar Serbinë, por i ka favorizuar kompanitë që kanë vepruar jashtë lejes ujore dhe kanë ndërtuar ilegalisht në burimet e ujit dhe pa njoftim sipas ligjit.

Në vend se të ngrihen në detyrë zyrtarët e ministrisë që kanë mbrojtur ligjin dhe buxhetin e shtetit, zyrtari që dilte në aq shumë fotografi me Liburnin dhe me Albinin, e kishte kundërshtuar vazhdimisht zyrtaren e Ministrisë së Mjedisit, duke u bërë jo avokat i shtetit, por avokat i kompanive private.

Madje, ka ushtruar ndikim te zyrtarja e Ministrisë së Mjedisit që të bëjë vazhdimin e lejes, pa marrë parasysh shkeljet e rënda ligjore që i kanë bërë.

Po i njëjti zyrtar, sipas Prokurorisë, vetëm në njëmbëdhjetë muajt e fundit ka blerë katër banesa dhe nuk i kanë deklaruar, ndërsa paga e tij është 732 euro. Të gjitha këto të ardhura apo mjete në konto që janë dorëzuar, nuk është alarmuar as nga BQK-ja.

Të nderuar,

Kjo aferë është e pastër korruptive. Tregon se Qeveria Kurti është e korruptuar deri në fund dhe e ka ndaluar çdo zhvillim në Republikën e Kosovës. Këta as nuk punojnë dhe gjithmonë e dëmtojnë Kosovën dhe e vjedhin shtetin e vet.

Të nderuar,

Falje e borxheve ndaj ambalazhuesve të ujit, pas arrestimit të zyrtarëve të Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e drejton Liburn Aliu, duhet të kthehet në pikën zero. Të anulohet vendimi për faljen e borxheve, të hetohet deri në fund nga Prokuroria çdo shlyerje e borxhit, të hetohet përfshirja e ministrit Aliu dhe Kryeministrit si dhe asaj të panjohurës Dejonës, me këtë rast me përfitimet e mundshme nga ambalazhuesit e ujit. Të themelohet komision hetimor parlamentar për aferën e faljes së ambalazhuesve të ujit dhe dyshimet për korrupsion.

Në fund, po ju them sepse Lëvizja Vetëvendosje në opozitë ka kërkuar që hajnat të shkojnë në burg. Kjo ishte veç një kauzë e rrejshme dhe për të ardhur vetë në pushtet dhe thjesht për t'u pasuruar dhe hajnat në Republikën tonë dhe në shtetin tonë janë pikërisht udhëheqësit e Lëvizjes Vetëvendosje.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani e ka fjalën deputetja Albana Bytyqi.

ALBANA BYTYQI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të dashur qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot po diskutojmë për një skemë korruptive, ku përfshirja nga ministri e deri te drejtori i departamentit tanimë është vërtetuar falja e borxheve të mëdha për disa kompani të fuqishme që operojnë në sektorin e ujit të ambalazhuar. Ka ngritur dyshime serioze për abuzim me pushtetin dhe favorizim me qëllim të përfitimit e pasurimit të njerëzve të Albin Kurtit, e rrjedhimisht edhe të vetë atij.

Në këtë skandal janë përfshirë disa nga drejtuesit më të lartë në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, përfshirë edhe ministrin aktual, sekretarin e ministrisë dhe drejtorin përgjegjës për pellgjet ujore, Naser Hafizin.

Ka dyshime dhe prova të forta që këta individë kanë qenë të përfshirë në vendime që i kanë shkaktuar një dëm financiar kolosal buxheti të Kosovës me falje borxhesh që tejkalojnë dhjetë milionë euro. Ky nuk është një gabim administrativ i thjeshtë, por një akt i qëllimshëm që favorizon interesa të caktuara dhe që godet rëndë interesat e qytetarëve të Kosovës. Hetimet tashmë kanë nisur nga Prokuroria Speciale dhe janë kryer bastisje në Ministrinë e Mjedisit, duke konfirmuar rëndësinë e kësaj çështjeje dhe nevojën urgjente për transparencë të plotë.

Pse institucionet tona kanë lejuar që borxhe të tilla të zhduken në mënyrë të dyshimtë, ndërkohë që qytetarët e Kosovës përballen me vështirësi të shumta ekonomike? A mund të pranojmë një Qeveri që flet për luftën kundër korrupsionit, ndërsa keqpërdorimi dhe mungesa e llogaridhënies mbizotërojnë në radhët e saj?

Kërkoj që të gjithë personat përgjegjës, përfshirë ministrin, sekretarin dhe drejtorin përgjegjës të mbajnë përgjegjësi të plotë për këtë skandal.

Qytetarët e Kosovës nuk mund të lejojnë që pasuritë e tyre të shpërdorohen në mënyrë të tillë dhe të përfitojnë disa të fuqishëm. Është koha që të zbardhet e vërteta dhe të rikthehet drejtësia për qytetarët.

Sa u përket këtyre bisedave të publikuara, ku shihet Dejona Mihaili se ka futur hundët edhe në KEK, nuk mendoj që është surprizuese. Ajo është njeriu i Kurtit dhe që i ecën fjala dhe bën pazare të tilla. Qeveria duhet të veprojë menjëherë për të ndaluar çdo abuzim të rrejshëm dhe për të kthyer besimin në institucione.

Kosova nuk mund të ecën përpara me keqmenaxhim dhe favorizime të tilla të turpshme. Falja e borxheve të tilla për dikë që ka sjellë pasuri brenda shtatë muajsh duke krijuar kapital milionësh, populli i Kosovës meriton llogaridhënie dhe drejtësi, jo korrupsion dhe pabarazi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ia jap fjalën deputetit Ferat Shala.

FERAT SHALA: Faleminderit kryesues!

Dua në kuadër të këtij debati vetëm ta kthej vëmendjen te legjislacioni në fuqi. Ligji për ujërat është mjaft i qartë. Kreu i tretë që përcakton me nene kompetencat dhe përgjegjësitë e Kryeministrit dhe ministrave vartës.

Neni 15 i Ligjit për ujërat thotë: “Këshilli ndërministror për ujërat. Thotë: i jep me dy pika. “Me këtë ligj themelohet Këshilli ndërministror për ujërat. Këshilli ndërministror për ujërat është trup koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështje sistimore administrative për ujërat, harmonizimin e nevojshëm të interesave të ndryshme, si dhe propozon masa për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve ujore, si dhe sistemin ujor të Kosovës”.

Neni 16: Përbërja e Këshillit. Pika 1: Këshilli ndërministror për ujërat përbëhet nga pesë anëtarë. Nën 2: anëtarët e Këshillit ndërministror për ujërat janë Kryeministri i Kosovës dhe katër ministra të linjës.

Pra, Këshilli udhëhiqet nga Kryeministri. Pra, neni 16 i Ligjit për ujërat e përcakton qartë përgjegjësinë juridike dhe kompetencat e Kryeministrit për të gjitha këto që kanë ndodhur dhe po ndodh me aferat në sektorin e ujërave.

Në nenin 17 kemi: Funkcionet dhe detyrat që dalin nga ligji për Kryeministrin dhe Këshilli ndërministror për ujërat. Ndërsa, neni 19 e përcakton qartë që Këshilli ndërministror për ujërat përgatit raporte vjetore, të cilat i raporton para Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Këto pjesë i lexova nga Ligji për ujërat për ta sensibilizuar edhe një herë Kryeministrin, për t'i treguar se ligjet mund të vonohen, por megjithatë drejtësia dhe ligjet duhet të respektohen dhe nuk është mirë t'u iket përgjegjësive ligjore që ka edhe para Kuvendi për të raportua për sektorin e ujërave, por edhe përgjegjësive direkte që ka mbi këtë sektor.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka deputeti Avdullah Hoti, ish-kryeministër i Kosovës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, profesor!

Kryesues i seancës,

Të nderuar kolegë,

Për çështjen që po debatojmë, kolegët e tjerë dhanë detaje të plota. Besoj, nuk do të thellohem në to. Është më se e qartë, një vlerësim shumë i lartë i borxheve, e mandej me veprime që duket qartë që kanë qenë joligjore, është reduktuar ky borxh në shifra qesharake.

Ky rast nuk është i vetmi që është tendencë për korrupsion të pastër qeveritar. Gjatë këtyre viteve në opozitë, besoj ju kujtohet, unë kam ngritur plot e plot çështje në hyrje të seancave, kryesisht te deklaratimet jashtë rendit të ditës, raste që në fakt përbëjnë bazë të qartë për korrupsion qeveritar.

Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj dhe të qytetarëve këto raste. Shpresoj që opozita me këtë temp që ka nisur në këto seanca të jashtëzakonshme të shkojë deri në fund këtyre rasteve, jo vetëm me deklarime në Kuvend, por të përdorë të gjitha mjetet ligjore e kushtetuese për të kërkuar informata të plota për këto çështje.

E para, janë avancet për investimet kapitale pa u përmbushur kushtet ligjore. Pra, po jap shifra për këto. Në vitin 2019 dhe në të gjitha vitet paraprake para kësaj Qeverie, vit pas viti ka pasur avance për investime kapitale, parapagesa për investime kapitale në shuma disa milionë euro. Në 2019 p.sh. ka qenë pesë milionë euro.

Gjatë këtij mandati 2021-2023, pa e përfshirë vitin 2024 ende, janë 196 milionë euro avance për investime kapitale. Ky është korrupsion. Kjo është bazë për korrupsion qeveritar. Unë kam kërkuar vazhdimisht, disa herë i kam përsëritur pyetjet parlamentare për ministrat përkatës, për ministrin e Financave, për të na dhënë informata në cilat raste janë paguar këto avance, a janë plotësuar kushtet ligjore, a janë marrë autorizimet e duhura për të dhënë avance për investime kapitale, asnjëherë nuk janë përgjigjur. Kurrë, asnjë herë. As në komision parlamentar dhe as këtu në seancë.

E dyta, janë subvencionet për ndërmarrjet publike, janë bazë korruptive. Blerja e energjisë me çmime që tash po bëhen publike se si janë lidhur ato kontrata dhe si janë menaxhuar negociatat për të blerë energjinë elektrike. Po, para së gjithash, subvencionet në total për ndërmarrjet

publike që janë pesëfishuar krahasuar me qeveritë paraprake, pa asnjë procedurë. Edhe këtu, disa herë kam shtruar pyetje parlamentare edhe Kryeministrit, edhe ministrave të na japë informata për cilat raste janë paguar këto subvencione për ndërmarrjet publike. Asnjëherë s'kemi marrë informata për këtë çështje.

Prandaj, këto nuk mbyllen vetëm me këtë debat.

Nën tre, korrupsion përbëjnë edhe skemat e ndihmave të ndryshme, pa ligj, por me vendime ekzekutive të Qeverisë dhe të ministrave përkatës. Disa skema janë krijuar deri më tash. Disa me arsye, disa pa ndonjë arsyetim konkret. Po gjithmonë, kur janë krijuar në të kaluarën, tash e njëzet vjet, skema të ndryshme pensionale dhe të asistencës, është krijuar baza ligjore nga Kuvendi i Kosovës për pagesën e këtyre skemave.

E katërta, korrupsion është edhe përkeqësimi i strukturës së buxhetit, duke i përgjysmuar investimet kapitale e duke i rritur subvencionet në rreth dyzet për qind të buxhetit. Kjo është arsyeja që në fund të mandatit katërvjeçar, ne nuk shohim asnjë rezultat konkret në terren nga kjo qeverisje.

E pesta, korrupsion janë kontrata njëburimore. Këtë e kemi qartësuar disa herë, edhe ju e keni adresuar disa herë. 2123 kontrata njëburimore. Ligji është i qartë për këto raste kur lidhet një kontratë njëburimore, pra kur nuk ka ofertues në treg, kur nuk lidhet kontratë burimore për furnizime më elementare nëpër ministri të ndryshme. këtu janë 273 milionë euro të lidhura me kontrata njëburimore. Vetëm informatat tash të sotme janë që vetëm në tremujorin e dytë të v. 2024 janë pesëmbëdhjetë milionë euro kontrata njëburimore të lidhura.

E gjashta, korrupsioni me rezervat shtetërore. Kemi diskutuar këtu në këtë Kuvend për manipulimin me furnizim sa u përket rezervave shtetërore. Nëse ju kujtohet, në programin qeveritar të kësaj mazhorance, edhe në fjalën e Kryeministrit kur e ka marrë mandatin dhe kur është votuar Qeveria, ka thënë: rezervat shtetërore do të mbushen nga prodhimi bujqësor vendor, duke i garantuar çmimin e produkteve bazë bujqësore dhe duke i blerë shteti të drejtat e produktit për t'i mbushur rezervat shtetërore.

Tani jemi në fund të mandatit dhe të gjitha këto secila prej tyre përbën skandal më vete. Unë shpresoj që do të jemi të vendosur si opozitë për të çuar deri në fund mandatin tonë, sepse e kemi obligim, jo vetëm deklaram politik, diskrecion për deklaram politik për seanca të jashtëzakonshme, por e kemi obligim kushtetues që si opozitë të kërkojmë llogari për të gjitha këto raste. Faleminderit!

KRYESUESI: Shumë faleminderit! Deputetja Albena Reshitaj e ka fjalën.

ALBENA RESHITAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Tani, meqë gjithë procesi i shkeljeve apo pretendimeve për shkelje në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është në procedura gjyqësore, për të mos interferuar në drejtësi, unë nuk do të përmend emra as të operatorëve ekonomikë, as zyrtarëve publikë të kësaj ministre. Por, do të flas me fakte për situatën që është krijuar, gjithmonë duke u bazuar në të gjitha informacionet që kam marrë nga analiza e tyre.

Për keqpërdorimet e pretenduara që janë bërë nga zyrtarë të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e që në fakt, në vend se të ndërpriteshin, ato vetëm kanë vazhduar të zgjerohen, duke krijuar një mundësi të një gjakderdhje financiare të rëndë, në kurriz të dëmtimit të resursit më vital natyral të vendit tonë, ujit.

Tentativa për faljen e borxhit këtyre operatorëve ekonomikë ka pasur edhe në qeveritë e kaluara, ku fatkeqësisht nga grupe të ndryshme të interesit, qoftë brenda ministrisë, apo edhe brenda operatorëve ekonomikë, paketohet kjo situatë në atë mënyrë duke e vënë si viktimë të këtyre borxheve, herë shfrytëzuesin, herë ministrinë.

Disa nga ta edhe mund të kenë pasur të drejtë, mirëpo, asnjëherë, edhe ministria nga viti në vit nuk e ka kryer obligimin e vet që të kërkojë raport si duhet dhe pagesat e ujit të bëhen si duhet për ministrinë. Pra, edhe gjatë mandatit tim si ministre, ka pasur tentime për zvogëlimin e borxheve të ujit për këta operatorë ekonomikë, por unë pas takimit me përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë dhe pas analizimit të bazës ligjore dhe konsultimit me ekspertë të fushës brenda dhe jashtë ministrisë, të cilët kanë dhënë sqarimet e duhura, që assesi me ligj nuk lejohet falja e shfrytëzimit të resurseve ujore, sqarime këto që kanë qenë aq të qarta për mua dhe që nuk kanë lënë vend për dilema. Kështu, kam vendosur të mos e procedoj më tutje këtë kërkesë për faljen e borxheve të ambalazhuesve të ujit.

Është provuar, pra, në fund të vitit 2017 që të falen borxhet, edhe duke më anashkaluar tashmë mua si ministre, edhe si pengesë njëkohësisht për këtë çështje, në mënyrën që donin ta realizonin në kundërshtim me Ligjin për ujërat dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Grupet e interesit krijuan një baj-pas duke më anashkaluar mua dhe zyrën ligjore të Ministrisë së Mjedisit, e cila refuzoi të bënte një vendim të kundërligjshëm. Këtë vendim e krijuan përmes drejtorit të atëhershëm të Departamentit të Ujërave.

Por, meqë Zyra Ligjore nuk ka pranuar të bëjë një vendim të jashtëligjshëm, atëherë këtë vendim e ka nxjerrë drejtori i Departamentit të Ujërave. Njëkohësisht, këtë vendim ia kanë paketuar dhe dërguar jashtëligjshëm për miratim edhe kryesuesit të Këshillit Ndërministror të Ujërave që të

falë borxhet. Mirëpo, menjëherë, pas një kohe shumë të shkurtër, duke u kuptuar se ishte vendim i jashtëligjshëm, ende pa hyrë në funksion, ky vendim është shfuqizuar dhe anuluar.

Keqpërdorimi i resursit ujor të Republikës së Kosovës, duke mos u paguar si duhet dhe sa duhet sipas Ligjit për ujërat, është në kundërshtim edhe me Kodin Penal të Republikës së Kosovës, pasi që keqpërdorimi i resursit ujor duke u eksportuar edhe jashtë vendit, pa i respektuar dispozitat ligjore e që bie ndesh me Kodin Penal, është edhe krim mjedisor.

Tani po i kthehemi situatës ku jemi sot.

Të nderuar qytetarë,

Në Ministrinë e Mjedisit, në tetor të vitit 2021, është krijuar grup punues për trajtimin e borxheve të operatorëve ekonomikë, dhe kjo pikërisht me kërkesë të ushtruesit të detyrës së drejtorit të Autoritetit Rajonal të pellgjeve lumore. Është punuar katër muaj në këtë grup punues dhe është krijuar një raport, i cili është dorëzuar për raportim në ministri. Mirëpo, shkeljet kanë filluar që tani. Kur këtij grupi punues nuk i janë dhënë në shqyrtim të gjithë operatorët ekonomikë, apo ambalazhuesit, por vetëm gjashtëmbëdhjetë prej tyre, nga njëzeteshtatë operatorë ekonomikë që funksionojnë në Republikën e Kosovës.

Pra, edhe nga këta gjashtëmbëdhjetë, dy prej tyre i kanë larguar si jofunksionalë. Pra, janë trajtuar vetëm katërmbëdhjetë operatorë ekonomikë, nga njëzeteshtatë operatorë ekonomikë që është dashur të trajtoheshin. Nga ky grup punues është nxjerrë një raport që borxhi i përgjithshëm për vitet 2006-2021 është vetëm 21 milionë euro për të gjithë operatorët e trajtuar. Kurse, sipas kalkulimeve të ekspertëve të fushës, vetëm një operator ekonomik ka borxhe prej 3 milionë e 555 mijë euro borxh shtetit. Pra, sipas kalkulimeve të ekspertëve, vetëm një raport ekonomik ka borxh 3.5 milionë euro.

Tani, prej një nga operatorët e këtij apo ambalazhuesit, i cili as që ka hyrë në trajtim nga grupi i ekspertëve, është ngarkuar në fund me një raport të palës, pra i është thënë atij ta sjellë një raport, i cili ka raportuar me të dhënat e tij.

Gjithashtu, një shkelje tjetër e pretenduar është se në përgjithësi këta operatorë nuk janë ngarkuar për kapacitetin maksimal të punës siç e kërkon udhëzimi administrativ sipas lejes, por vetë për dhjetë orë punë për treqind ditë. Pra, për njërin nga këta operator që hyn ndër operatorët më të mëdhenj me 5 l/s, ka paguar trembëdhjetë mijë euro për vitin 2009 deri në qershor 2021. Dhe, menjëherë në korrik, pra në dhjetor ka paguar mbi njëzet mijë euro dhe atë vetëm për tarifën 0,01 për litër të shitur.

Përderisa, prej 2009 deri në 2016 tarifa ka qenë 0,09 për litër të shitur, që i bie 9 herë më shtrenjtë. Tani si ka mundësi një diskrepancë kaq e madhe e pagesave. Si është mundur kur

fillimisht, sipas informatave që kam siguruar, kjo kompani kishte dërguar në ministri një raport me mbi 80 mijë euro borxh për vitin 2009-2021. Mirëpo, këtij operatori ekonomik i është kërkuar që të kalkulojë edhe një herë borxhin e tij pasi që ishte thënë se ke mundur të bësh një kalkulim të gabuar. Dhe, më pastaj ka sjellë në ministri një raport tjetër me 13 euro borxh.

Ndonëse kalkulimi i ekspertëve e çon borxhin e këtij operatori ekonomik në mbi 3 milionë euro për vitet 2009-2021.

Nëse e krahasojmë me një operator tjetër, i cili kishte paguar vetëm prej qershorit të vitit 2020 deri në qershor të vitit 2021, 155 890 euro. Pra, përderisa ky operator ekonomik e ka edhe lejen shumë më të vogël për 0,9 litra në sekondë maksimale, që i bie 5 herë më të vogël se operatori ekonomik në fjalë për të cilin biseduam më herët.

Prandaj, si është e mundur që Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nga të njëjtit zyrtarë të përdorë standarde të dyfishta. Prandaj, ushtruesi i detyrës së drejtorit edhe pse kishte themeluar vet komisionin për përlllogaritjen e borxheve sipas shfrytëzimit maksimal, ai kishte shpikur një praktikë komplet të jashtëligjshme, duke krijuar hapësirë për manipulime me operatorë.

Fillimisht kishte lëshuar vendime preliminare dhe u kishte bërë thirrje operatorëve ekonomikë të raportojnë, dhe me këtë ai përveç që nuk kishte marrë për bazë rekomandimet e grupit punues, i cili kishte kërkuar nga autoriteti rajonal i pellgjeve lumore të nxjerrin vendime financiare dhe t'ia bashkëngjitin edhe faturës sipas përlllogaritjes që ky grup e kishte bërë siç e parasheh ligji.

Drejtori nuk e kishte përfillur as nenin 9 të udhëzimit administrativ 062021, i cili kërkon nga ministria që nëse operatori nuk ka raportuar deri më datë 15 janar për vitin paraprak, atëherë ministria brenda 30 ditës, pra nga 15 janari i vitit paraprak është i detyruar të nxjerr vendim financiar dhe të bashkëngjij faturën sipas shfrytëzimit maksimal në kapacitet të plotë.

Pra, këtu u është lejuar operatorëve mundësi të mos përgjigjes dhe të mos respektimit të dispozitave ligjore. Në preambulën e këtyre vendimeve preliminare, drejtori kishte potencuar nenin 108, duke tentuar të manipulojë me njoftim-vendim preliminar përderisa ky nen shumë e qartë e potencon në paragrafin 2 se njoftimet mund të dërgohen vetëm nëse parashihet shprehimisht ndryshe me ligj.

Ndërsa në rastin konkret, Ligji bazë i ujërave, siç e potencova, edhe udhëzimit administrativ për strukturën e pagesave e parasheh shprehimisht me ligj nxjerrjen e vendimeve financiare sipas shfrytëzimit maksimal duke i bashkëngjitur faturën brenda 30 ditëve nga 15 janari për vitin paraprak. Që i bie që ai i ka manipuluar duke i përdorur këto njoftime-vendime preliminare për

shantazh ndoshta ndaj operatorëve që t'i krijojë vetes mundësi për të hyrë në negociata ndoshta me ta. Dhe, siç duke diçka është arritur...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë. Regjia, edhe një minutë, ju lutem!

ALBENA RESHITAJ: Pra, e gjithë kjo lë për të dyshuar se këto pretendime mund të jenë të vërteta. Pra, i gjithë ky manipulim që mund të ketë ndodhur është bërë që të krijohet mundësia po edhe shantazhimi i operatorëve ekonomikë që të detyrohen të krijojnë marrëveshje përderisa vendimet financiare pas këtyre njoftimeve janë zvogëluar diku rreth 90% të borxhit.

Unë jam informuar që nga viti 2022, Këshilli Ndërmintor për Ujëra ka qenë i njoftuar me shkrim për këtë gjakderdhje të mundshme financiare, ku sipas nenit 15 të Ligjit të ujërave, të Këshillit Ndërmintor që është trup koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujërat, si dhe propozon masa zhvillim, shfrytëzim dhe mbrojtjen e resurseve ujore, ka qenë i informuar.

Nëse dikush nga zinxhir i mundshëm i keqpërdorimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Radhën e ka deputeti Rashit Qalaj.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë,

Të nderuara media,

Është bërë tash rutinë e punës së Kuvendit që përditë sa herë të kemi seancë të jashtëzakonshme të flasim për aferat korruptive dhe skandalet e Qeverisë dhe të deputetëve të mazhorancës.

Siç duket këto afere janë punë rutinë e Qeverisë meqenëse nuk po kemi asgjë tjetër përveç skandale, e skandale, e skandale. Këto skandale tentohet të manipulohen nga ministrat dhe nga resorët përgjegjës.

Kemi folur në këtë foltore këtu për aferën e grurit dhe të rezervave shtetërore, e të vajit, dhe ka tentuar ministrja të na bind që nuk ka qenë e involvuar, që nuk ka kontaktuar direkt me persona fizikë, me Ridvan Muharremin. Por, rrena i ka këmbët e shkurtra dhe e pamë se si ka qenë komunikimi.

Po ashtu e kemi bërë temë çështjen e Nagip Krasniqit edhe të KEK-ut. U pa nga komunikimet me nëntokën e Vetëvendosjes se si është menaxhuar KEK-u dhe si është menaxhuar rryma në Kosovë.

Kemi folur shumë për skandale, shkelje kushtetuese. Kemi parë shumë skandale të ministrave të dënuar nga gjykatat. Kemi folur shumë për problemet që i kanë institucionet e Kosovës, policia, ushtria, institucionet e tjera, vetëm e vetëm për shkak të aferave korruptive dhe qëllimeve shumë të këqija të kësaj Qeverie.

Folëm në seancën e kaluar për problemet me ushqim të Forcës së Sigurisë së Kosovës, dhe po ashtu e diskutuam edhe letrën që komandanti i saj i ka drejtuar ministrit të Mbrojtjes. Në përfundim të asaj letre ai thoshte se do të jenë të detyruar që t'i limitojnë operacionet e tyre. Pra, çështjet operative.

Të nderuar deputetë,

Nga informatat nga brenda nga sinjalizuesit, bordi brenda FSK-së i ka rekomanduar komandantit të tyre që trajnimin bazik që është dashur ta fillojë më 28 tetor të këtij viti, ta shtyjë për vitin e ardhshëm. Po ashtu, 300 rekrutët që është dashur të punësohen këtë vit, ata do të punësohen vitin e ardhshëm për shkak se nuk ka ushqim.

Kemi parë skandale të ndryshme, por që nuk është folur shumë. Skandali në Qendrën e Studentëve, ku nga ministrja që është edhe shkelëse e Kushtetutës, shkarkohet një luftëtar i lirisë, zoti Fatmir Sfishta, ndërsa emërohet dikush, i cili ka qenë paraprakisht i dënuar për shkak të shkeljeve disiplinore dhe për këtë është diskutuar nëpër televizione.

Dhe, ky militant i Vetëvendosjes tanimë punëson militantë të Vetëvendosjes, shokë e shoqe. Punëson djem të kryetarëve të komunave, siç është rasti me kryetarin e Komunës së Podujevës, me djalin e tij, Arbër Bulliqi. Pra, kemi parë rrena e gënjeshtra të ndryshme.

Afera “zdravo” afëra e dytë “brate” tregojnë se si janë në linjë me Listën e serbe këto kapelat e zeza që i kemi këtu përpara. Paramendojeni që zonja Mimoza Kusari-Lila tentonte ta gënjejë, ta rrejë një popull të Kosovës se fjala brate në gjuhën serbe, nuk e ka kuptimin vëlla, por e ka mik.

Unë, thënë të drejtën e kam zërë shumë të madhe kur ajo edhe Simiqi i kanë fyer heronjtë e gjallë të këtij vendi, veteranët e luftës. I kanë fyer deputetët këtu, se kanë menduar që e kanë fyer me një koleg deputet të Listës serbe, po kur ka mësuar që e ka fyer me “vëllain” e saj Simiqin, atëherë çka të them.

Pra, me “vëllain” e saj Simiqi e fyen Ramush Haradinajn, e fyen Bekim Haxhiun, e fyen Abelard Tahirin, e fyen Uran Ismailin. I fyen deputetët e këtij Parlamenti.

Të nderuar deputetë,

Të gjithë këta ministra nuk e kanë gajle pse manipulojnë. Absolutisht nuk kursehen duke na gënjyer përditë dhe duke na rrejtur në sy. Ama bash gajle s'e kanë fare. Të rrejnë ndër sy dhe jo vetëm që të rrejnë, por të sosin krejt.

E kam përshtypjen që edhe kur shkojnë në shtëpi dhe dalin para pasqyrës edhe fillojnë mburren se si i kanë rrejtur të gjithë kolegët deputetë dhe popullin e Kosovës. Por, mburren më shumë se po e rrejnë atë që e shohin në pasqyrë. Dhe, kjo është e keqja më e madhe se ata e rrejnë edhe vetveten, se vetëm vetveten e shohin në pasqyrë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës ia jap fjalën deputetes Rrezarta Krasniqi. Regjia, deputetes Rrezarta Krasniqi ia jap fjalën.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Thënë të drejtën, edhe pse kjo seancë sot ka një temë specifike, dilemë kemi pasur se nga t'ia nisim fjalimit; prej cilit skandal, prej cilës aferë dhe prej cilës hajni.

Kësaj Qeverie më nuk po i mjafton një skandal korruptiv ose një aferë me kriminelë e terroristë në ditë. Tash kanë filluar nga dy-tri në ditë t'u dalin në shesh.

Këto ditë jemi dëshmitarë të një skeme të rrezikshme parapolitike të anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët dirigjojnë të gjitha kabinetet qeveritare dhe jo vetëm, po del që ata janë njerëz pa funksion shtetëror, e po komandojnë edhe me institucionet e tjera publike që janë të ndara nga organet e Qeverisë.

Dejona, kjo grua e fuqishme e cila vendos se kur dhe ku të mos ketë rrymë. Mimoza, e cila koordinohet me Radoiçiqin dhe vëlla e ka Simiqin. Martini e Nagipi që po vjedhin rrymë, e shok i këtij grupi kriminal është edhe Naser Hafizi, i cili u falë miliona euro borxh ambalazhuesve të ujit në emër të Qeverisë, dhe i gjithë ky rrjet kriminal e ka vetëm një emër të përbashkët, e ai është Albin Kurti.

Kur vodhën në grurë e në vaj, pra, në artikuj bazë të jetesës, kam menduar se s'ka ku shkon më keq. Ku ka më keq se të vjedhësh në rezervat e ushqimit bazë, ushqimin esencial, dhe atë në kohën e krizës së pandemisë, kur njerëzit po vdisnin në spitale dhe spitalet ishin përplot të mbushur qytetarë të sëmurë.

Por, vodhën në grurë e në bukë, s'ka më keq. Por, ka një gjë më esenciale për jetën e njeriut sesa buka, është uji. Këta vodhën edhe në ujë. Do të thotë, se e kisha pasur gabim. Paska edhe më keq se të vjedhësh në bukë, pra, ta vjedhësh ujin.

Kjo Qeveri, kjo parti në pushtet janë munduar që ta zbresin në borxh rreth 19 milionë euro në 1 milion euro, duke u munduar t'ia humbin buxhetit të Republikës së Kosovës rreth 18 milionë euro. Pra, e përsëris, rreth 18 milionë euro.

Pra, 18 milionë euro që i takojnë buxhetit të qytetarëve të Republikës së Kosovës me të cilat do të mund të nderoheshin shumë shkolla, çerdhe, spitale e rrugë. Janë munduar që t'i falin këto 18 milionë euro nga llogaria e Kosovës sonë, e në anën tjetër t'i mbushin llogaritë personale me qindra-mijëra euro.

Janë munduar, por kjo ka dështuar. Krejt kjo e planifikuar me një skemë brenda Qeverisë së Republikës së Kosovës, e specifikisht në Ministrinë e Mjedisit dhe planifikimit hapësinor. Si filloi e gjithë kjo. Me të marrë detyrën ministri Liburn Aliu fillon gradimin e jashtëligjshëm të veglës së tij, Naser Hafizit.

Këto gradime nuk ishin të rëndësishme, por një pjesë e një plani korruptiv për të arritur deri në këtë pikë të dëmtimit të buxhetit të qytetarëve me miliona euro.

Së pari, Hafizi u gradua nga zyrtari për financa në zëvendës së udhëheqësit të divizionit për paga dhe projekt, e më pas nga këtu u emërua ushtrues detyre i drejtorit të Autoritetit Rajonal të Pellgjeve Lumore. Gradim pas gradimi për Hafizin për të mbërri në pozitën e dëshiruar për ta korruptuar vendin.

Lidhja e Hafizit me strukturat e partisë në pushtet janë të pamohueshme nga favorizimet e gradimet e paligjshme nga ministri Liburn Aliu, e deri te fotografitë e shumta me kryeministrin Albin Kurti. Alni thotë se nuk kam informacione, kur pyetet për aksionin e policisë në Ministrinë e Mjedisit. E sinjalizuesit e kanë informuar Albin Kurtin për këto vjedhje qysh në dhjetor të vitit 2022, por Albini ka vendosur t'i injorojë këto informata.

U mbetet qytetarëve të vlerësojnë pse ka Albin Kurti vendosi heshtjen përballë këtyre informatave, edhe pse Albin Kurti gënjeu kur tha se nuk kam informacione.

Me gjithë këto skandale korruptive, hajnia e afera vërehen në dy trajektore. E para, bashkëpunimi vëllazëror me struktura kriminale serbe dhe me kompani serbe energjetike, dhe e dyta, hajni me produktet më bazike ushqimore esenciale dhe në gjëra pa të cilat ky popull në gjendje të rëndë sociale ekonomike nuk mund të mbijetojë, në bukë e në ujë.

Albin, jemi duke të pritur që ta mbash premtimin, hajnat në burg. Por, jo vetëm hajnat, zyrtarët e manipuluar të cilët i ke bërë vegla, por të gjithë ministrat tuaj dhe njerëzit tuaj rreth teje.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,
Të nderuara kolege e ju kolegë deputetë,
Pamja e kësaj salle flet më së miri për gjendjen ku e ka katandisur Kuvendin ky pushtet dhe Qeveria e Albin Kurtit.

Jemi mësuar të dëgjojmë shpesh kritika se po bëjmë opozitë të butë, nuk po jemi mjaftueshëm të ashpër, nuk po jemi agresivë ndaj këtij pushteti. Në rrugën komplet ligjore, në rrugën komplet demokratike me argumente e fakte jemi duke e bërë një opozitë dhe e shihni. E kanë marrë malin. Nuk është asnjë në sallë. Nuk guxon asnjë të vijë e të përballet me të vërtetën dhe me realitetin. Me faktet dhe me argumentet që ne i qesim këtu.

Merreni me mend, sikur ne si opozitë të gjuanim gaz lotsjellës, ta gjuanim Kuvendin me zollë, krejt këta që janë këtu edhe këta që do të duhej të ishin këtu, do të merrnin azil politik diku.

Të dashur qytetarë,

Jemi mbledhur sot këtu për të diskutuar për një çështje që është shumë jetike dhe shumë me rëndësi. Jemi mbledhur për të folur për keqpërdorimin e Qeverisë me ambalazhuesit e ujit që është një mega-skandal i radhës i kësaj Qeverie, sepse nuk është as i pari, dhe deri më 9 shkurt, jam shumë e bindur që s'do të jetë as i fundit.

Të nderuar qytetarë,

Çka të flas për Albinin dhe Qeverinë e tij që e ka tradhtuar besimin e qytetarëve dhe e ka shkelur me të dyja këmbët. Çka të flas për ambalazhuesit e ujit kur Albin Kurti dhe Qeveria e tij vjedhin, abuzojnë pasuritë e vendit tonë çdo ditë dhe e kanë lënë popullin në varfri dhe dëshpërim.

Çka të flas për Albinin dhe këtë Qeveri që tallet me ata që luftojnë çdo ditë për të mbijetuar, sepse për të jetuar as që bëhet fjalë më në këtë vend. Albin Kurti dhe Qeveria e tij e ka humbur lidhjen me realitetin e qytetarëve, duke e bërë jetën më të vështirë për ata që kanë më së shumti nevojë.

Kjo Qeveri e sulmon fjalën e lirë, duke e shndërruar debatin në heshtje dhe frikë. Ne nuk do të lejojmë që zëri ynë të zbutet. Ne do ta ngremë zërin tonë për drejtësi, transparencë dhe për liri. Por, kjo nuk mjafton që t'i largojmë retë e zeza që i kanë rënë përmbi Kosovës tash e 5 vjet.

Prandaj, të dashur qytetarë, ejani e bashkoheni me ne në këtë luftë për një të ardhme me të mirë. Për një Qeveri që i shërben popullit, e jo për një Qeveri që e shndërron popullin në shërbëtor. Jo për një Qeveri që u shërben dostava. Jo për një Qeveri që i shërben vëllazëritëkut, miqve.

Të mos lejoni që një njëri që fëmijën e tij nuk ka besim ta rrisë në vendin që qeverisë vetë, të tallet me ju e me fëmijët tuja. Prandaj, të dashur qytetarë, ne nuk do të ndalemi, erdhën apo nuk erdhën ata mandatin do ta çojmë deri në fund.

Do të shpalojmë çdo ditë të bëmat e kësaj Qeverie, e cila e ka katandisur vendin në një humnerë e në një mjerim.

KRYESUESI: Faleminderit! Abelard Tahiri, shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së e ka kërkuar fjalën për procedurë.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

Ashtu siç e paralajmëruam edhe më herët si shefa të grupeve parlamentare të partive opozitare në Kuvendin e Kosovës, ne tani do ta ndërpresim seancën me një arsye të vetme që para Radio Televizionit të Kosovës ta mbajmë një konferencë për media dhe t'i adresojmë çështjet të cilat na brengosin jashtëzakonisht shumë.

Sjellja e Radio Televizionit të Kosovës karshi opozitës dhe Kuvendit të Kosovës është e pa tolerueshme. Pra, bllokimi i fjalës. Tentimi për ta shmangur nga vëmendja e qytetarit aferën të cilën e ekspozon një grup parlamentar është i papranueshëm.

Prandaj, ne do ta ndërpresim seancën, dhe si deputetë të opozitës do të shkojmë tani para objektit të Radiotelevizionit të Kosovës ta mbajmë një konferencë për media. Faleminderit!

KRYESUESI: Domethënë, Abelard, po kërkoni që të ndërpritet seanca dhe të mos vazhdojë sot?

ABELARD TAHIRI: Sot, jo! Vazhdojmë në një moment tjetër.

KRYESUESI: Në rregull! Atëherë, sipas kërkesë së iniciuesit të kësaj seance, unë e ndërpres këtë seancë këtu për sot. Mirupafshim!

* * *

E mërkurë, më 30 tetor 2024

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 16 tetor 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Tani e kemi çështjen e datës 16 tetor, e që është:

1. Debat parlamentar për procesin e përlogaritjes së borxheve të kompanive ambalazhuese të ujit, si dhe për mënyrën dhe për bazën e shlyerjes së borxheve nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Edhe kemi çështjen e fundit, por për të cilën nuk është paraqitur më duket ende rezolutë. Kështu thotë procesverbali ynë i seancës së asaj dite, sepse opozita e ndërpreu atë, e ndali, dhe ishte për borxhet e kompanive ambalazhuese të ujit. Kështu që, e lëmë këtë, sepse është mirë ta paraqesin rezolutën propozuesit, e pastaj e votojmë.

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë